



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.4.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Raporti vjetor për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Antoneta Dhima, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Bujar Leskaj, Jorida Tabaku dhe Blerina Gjylameti.

Mungojnë:

Edmond Spaho, Alfred Rushaj dhe Agron Shehi.

Të ftuar:

Denar Biba – Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës

Adriana Berberi – Anëtare e Autoritetit të Konkurrencës

Rezana Konomi – Anëtare e Autoritetit të Konkurrencës

Leida Matja – Zëvendëskryetare e Autoritetit të Konkurrencës

Diana Dervishi – Sekretare e Përgjithshme e Autoritetit të Konkurrencës

Endi Çekani – Drejtor i Kabinetit në Autoritetin e Konkurrencës

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Kuorumi është në rregull.

Mediat mund të futen brenda.

Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sot në rendin e ditës kemi raportin vjetor të veprimtarisë të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021. Relatore për këtë çështje kemi zonjën Blerina Gjylameti dhe zonjën Sorina Koti.

Të ftuar për të raportuar kemi kryetarin e Autoritetit të Konkurrencës, zotin Denar Biba, i cili shoqërohet nga zonjat Leida Matja, Adriana Berberi, Rezana Konomi së bashku me zonjën Diana Dervishi, sekretare e Përgjithshme dhe zotin Endi Çekani, drejtor i Kabinetit, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision!

Dua t'i jap fjalën zotit Biba për të prezantuar veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021. Më pas fjalën e kanë relatore, zonja Gjylameti dhe zonja Koti, përpara se të kalojmë te faza e pyetjeve dhe e diskutimeve, në qoftë se do të ketë.

A jeni dakord me rendin? Në rregull.

Zoti Biba, fjala për ju.

Denar Biba – Përshëndetje dhe faleminderit të gjithëve për mundësinë për të qenë sërish këtu pranë jush! Në një lloj konteksti, ne jemi zgjatim institucional normal i Kuvendit, pra të gjitha institucionet e pavarura që zgjidhen nga Kuvendi i Republikës.

Komisioni i Konkurrencës ka miratuar raportin vjetor për vitin 2021 dhe i është dërguar Kuvendit të Republikës dhe komisionit përkatës që na mbulon. Dua të bëj një prezantim të shkurtër, por ne jemi të gatshëm t'u përgjigjemi të gjitha pyetjeve dhe shqetësimeve tuaja.

I nderuar zoti Shalsi,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2021 ka përmbushur detyrimet ligjore, që rrjedhin nga ligji nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”, për të garantuar respektimin e rregullave të lojës së ndershme nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me prioritet plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020”. Gjatë vitit 2021, praktikisht, ne, si Komisioni i Konkurrencës, kemi marrë 94 vendime.

Në mënyrë të përmbledhur vendimmarrja ka konsistuar në një sërë gjetjesh në formën e rekomandimeve, autorizimeve, vlerësimeve ligjore, masave të përkohshme, por edhe sanksione në formën e gjobave. Konkretisht, Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2021 ka realizuar në tregjet sensitive, me ndikim të drejtpërdrejtë për mirëqenien e konsumatorit 12 monitorime, praktikisht, në tregun e telefonisë celulare, e prokurimeve publike, e sigurimeve, produktet paramjekësore, grurit dhe miellit, naftës bruto, vajit vegjetal, menaxhimit të faciliteteve të parkimit të *Tirana International Airport*, arsimit të lartë, FSHF-së dhe tregut digjital. 10 prej këtyre monitorimeve janë shndërruar në procedura hetimore.

Referuar shtyllave të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, hetimet e realizuara nga Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2021 janë si më poshtë:

Hetime për marrëveshje të ndaluara në tregun e shërbimeve bankare; në tregun e importit, të prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal; në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore; në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore; në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inuteve bujqësore; në tregun e prokurimit me objekt “Blerje ushqimesh për vitin 2021” të zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve të Bashkisë Tiranë; në tregun e prokurimit të shërbimit të shtypshkrimeve, zhvilluar nga autoritetet kontraktore AKBPM, Posta Shqiptare, UKT, OSHEE dhe UKD.

Gjithashtu, kemi zhvilluar hetime për abuzim me pozitën dominuese në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të *Tirana International Airport*; në tregun e importit, të depozitimit të shitjes me shumicë të produktit gaz i lëngshëm i naftës; në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve; në tregun ku operojnë subjektet financiare jobanka dhe tregun e shërbimeve spitalore.

Kontrolli i përqendrimeve, e cila është kolona e tretë e ligjit, në zbatim të neneve 10 dhe 12, është realizuar nëpërmjet vlerësimit të 31 rasteve, të cilat e kanë përmbushur kriterin për të qenë të njoftuara në Autoritetin e Konkurrencës, ndërkohë në 11 raste nuk e kanë përmbushur kriterin dhe nuk janë autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës pikërisht sepse nuk kanë qenë të njoftuara, në respekt të ligjit.

Në kuadër të përqendrimeve, Autoriteti i Konkurrencës ka derdhur në buxhetin e shtetit shumën 16 milionë e 658 mijë lekë. Tregu financiar dhe tregu i sigurimeve janë tregjet më të prekura nga transaksionet e ndryshimit të kontrollit, të ndjekura nga tregu i energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2021 Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të ligjit, ka vendosur dhënien e rekomandimeve për 8 institucione publike. Në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe të detyrimeve që tërheqim nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe në reflektim të problematikave që kanë dalë nga zbatimi i ligjit, Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar detyrat në kuadër të Planit Kombëtar për Integritimin dhe, si vend kandidat, i është lënë edhe detyra për rishikimin e kuadrit ligjor në fushën e konkurrencës. Kjo është vërejtur edhe në kuadër të dy rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2019” dhe atë për vitin 2020, ku autoriteti ka marrë detyrën nga Kuvendi që të paraqesë amendime në lidhje me ligjin “Për mbrojtjen e Konkurrencës” që nuk është realizuar deri tani.

Gjatë vitit 2020 Autoriteti i Konkurrencës, në kuadër të kësaj detyre të lënë nga rezoluta përkatëse të Kuvendit të Republikës, ka nisur një proces për identifikimin e problematikave në ligj dhe, në kuadër të procesit *IPA Twinning* për forcimin e kapacitetesh midis Autoritetit shqiptar të Konkurrencës dhe Komisionit Kombëtar spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën është evidentuar se përgjithësisht ligji nr.91/21 “Për mbrojtjen e konkurrencës” është një i përafuar *acquis*-të e BE-së.

Procesi i rishikimit të ligjit është i gjatë, synon të jetë gjithëpërfshirës, ku përveç kontributit të autoritetit, që është një kontribut i specializuar në këtë proces, do të përfshihen institucione qendrore e të pavarura, si dhe palë të treta, si dhomat e tregtisë, studiot ligjore dhe shoqatat e biznesit. Praktikisht, që në janar të këtij viti Autoriteti i Konkurrencës ka ngritur një grup pune për realizimin e mendimeve. Jemi duke punuar; kemi pothuajse një draft gati dhe po vazhdojmë të punojmë mbi të, në mënyrë që të shkojmë drejt synimeve tona për t’i dhënë Kuvendit një produkt sa më perfekt. Të gjitha procedurat synohen të arrihen në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Nënvizojmë faktin se mosrealizimi i kësaj detyre deri më tani nuk e ka cenuar funksionimin normal të punës në autoritet, sepse legjislacioni që është aktualisht është pothuajse i përshtatur me *acquis*-të e BE-së. Ky nuk është vlerësimi ynë, por edhe i prezencës së Komisionit të BE-së, por edhe i strukturave të huaja që na kanë monitoruar. Gjatë vitit 2021 u kemi kushtuar rëndësi të veçantë ndjekjes së procedurave gjyqësore, duke qenë aktivë në të gjitha proceset në shkallët e gjykimit nëpërmjet paraqitjes së argumenteve dhe provave në mbështetje të vendimeve të marra nga Komisioni i Konkurrencës. Ndjekja e çështjeve gjyqësore

lidhet me ndikimin që kanë vendimet e Komisionit të Konkurrencës në tregun përkatës dhe në publikun e gjerë, si dhe me faktin që pothuajse të gjitha vendimet e Komisionit i janë nënshtruar procesit të ankimit në gjykatë.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë të Tiranës gjatë 2021 janë shqyrtuar 20 çështje, për të cilat 17 janë lënë në fuqi vendimet komisionit ndërsa në tri raste janë shfuqizuar dhe vazhdojnë ankimet në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2021, në zbatim të ligjit 9121/2003, ka vlerësuar 35 akte normative, nga të cilat: 30 akte nënligjore në tregun e energjisë dhe të gazit; 2 akte nënligjore në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e të përpunimit të ujërave; 2 akte nënligjore në fushën e prokurimeve publike dhe 1 vlerësim koncesioni ka qenë ai për aeroportin e Vlorës.

Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit dhe respektimit të afateve të parashikuara në Planin Kombëtar të Integritimit për vitet 2021-2023, kemi ka miratuar 2 akte nënligjore të autoritetit, praktikisht dy udhëzime: udhëzimin “Për praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve” dhe udhëzimin “Për praktikat më të mira për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave, në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe në rastet e përqendrimeve”.

Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet procedurave të parashikuara realizoi konsultimin publik për udhëzimin “Për praktikat më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve” për ta sjellë sa më afër të gjithë legjislacionin tonë dhe aktet nënligjore me *acquis*-të e BE-së.

Autoriteti është angazhuar edhe në drejtim të promovimit të avokatisë, por kujtoj si viti 2020 dhe viti pasues 2021 kanë qenë vite në pandemi. Kështu që edhe mundësia për të zhvilluar takime, seminare dhe *workshop*-e kaq relativisht e kufizuar.

Gjatë veprimtarisë së vitit 2021 Autoriteti i Konkurrencës ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë. Në këtë kuadër, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Autoritetin grek të Konkurrencës.

Gjatë vitit 2021 përdorimi i buxhetit të miratuar për Autoritetin e Konkurrencës ka qenë konform kërkesave të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe është përdorur me

efikasitet për plotësimin e kushteve dhe kërkesave të punonjësve, për realizimin e detyrave të ngarkuara për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Faleminderit për dëgjimin!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti kryetar!

Fjalën e ka zonja Gjylameti dhe më pas zonja Koti.

Më pas do ta kenë fjalën kolegët për pyetje.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Për sa i përket vlerësimit të performancës së institucionit nga këndvështrimi i Shërbimit të Monitorimit, që është një nga institucionet që merret rregullisht me vlerësimin e punës së Autoritetit të Konkurrencës dhe me pasqyrimin e të gjitha rekomandimeve të lëna nga rezoluta e mëparshme, autoriteti gjatë vitit 2021 vazhdoi veprimtarinë e tij nën ndikimin e pasojave dhe kufizimeve të vendosura për shkak të pandemisë COVID-19. Megjithatë, në krahasim me vitin 2020, puna e sekretariatit u intensifikua për realizimin e monitorimeve për tregje dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare që u reflektuan më pas në vendimmarrjen përkatëse të Komisionit.

Në mënyrë të detajuar veprimtaria e institucionit për vitin 2021, bazuar në prioritetet e vetë institucionit, rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, në problematikat e evidentuara në mjetet e informimit publik apo ankesat e depozituara sipas përcaktimeve ligjore, rezultoi si më poshtë: Komisioni i Konkurrencës ka miratuar një total prej 94 vendimesh, nga 87 vendime të miratuara në vitin 2020 dhe 93 vendime të miratuara në vitin 2019, të cilat ndahen si vijon: 31 vendime për autorizim përqendrimesh nga 19 vendime të dhëna në vitin 2020; 24 vendime për abuzim me pozitën dominuese nga 7 vendime të dhëna në vitin 2020; 20 vendime për marrëveshje të ndaluara nga 7 vendime të dhëna në vitin 2020; 2 vendime për miratimin e rregulloreve dhe/ose udhëzuesve nga 4 vendime të dhëna në vitin 2020; 9 vendime për dhënien e rekomandimeve ndaj institucioneve publike nga 10 vendime të dhëna në vitin 2020; 1 vendim për vendosje gjobe dhe 3 vendime për zbatimin e masave të përkohshme nga 11 vendime të dhëna në vitin 2020; 1 vendime për marrjen e masave të përkohshme nga 3 vendime të dhëna në vitin 2020.

E gjithë vendimmarrja e Komisionit për vitin 2021 është përmbledhur në 28 mbledhje dhe është pasqyruar më pas në faqen e internetit të institucionit. Megjithatë, nga një kontrolli i faqes rezultoi se një numër i konsiderueshëm i vendimeve nuk janë publikuar brenda afateve dhe

sipas përcaktimeve të nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”. Edhe për vitin 2022 situata rezulton e njëjtë; deri në fund të muajit mars janë publikuar vetëm tri vendime të Autoritetit të Konkurrencës në kategorinë e marrëveshjeve të ndaluara.

Gjithashtu, referuar përmbajtjes së vendimeve, nuk bëhet transparent procesi vendimmarrës i anëtarëve të Komisionit; kjo për të kuptuar a janë zbatuar plotësisht përcaktimet e neneve 23 dhe 26 të ligjit kuadër që lidhen me konfliktin e interesit dhe me vlefshmërinë e marrjes së vendimeve.

Institucioni gjatë vitit 2021 është angazhuar në realizimin e 12 monitorimeve të tregjeve specifike, nga të cilat 7 monitorime kanë filluar që në vitin 2020, për të cilat është parashikuar një afat monitorimi nga 1 deri në 2 vjet. Në krahasim me vitin 2020, janë realizuar 7 monitorime më pak.

Për sa u përket tregjet e monitoruara, e përmendi edhe më parë drejtuesi i Autoritetit të Konkurrencës janë kryesisht: tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal; tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të *Tirana International Airport*; sektori i arsimit të lartë; tregu i importit të grurit; i importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit; tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto; tregu i sigurimeve për produktin “Karton jeshil”; tregu i sigurimeve për produktin TPL; tregu i veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit; tregu me pakicë i shërbimeve celulare dhe një pjesë tjetër që ka një rëndësi të posaçme për t’u përmendur është tregu i prokurimeve publike për produkte të caktuara.

Gjatë veprimtarisë njëvjeçare është bërë vlerësimi i 42 rasteve të kontrollit të përqendrimeve, nga 27 raste të kontrollit të përqendrimeve të vlerësuara në vitin 2020, nga të cilat komisioni ka klasifikuar dhe ka autorizuar 31 raste dhe nuk ka klasifikuar 11 raste. Tregjet më të prekura nga transaksionet e ndryshimeve dhe të kontrollit vazhdojnë të jenë edhe për vitin 2021 tregjet financiare dhe të sigurimeve që ndiqen më pas nga tregu i energjisë elektrike.

Nga 31 përqendrimit e autorizuara 27 vendime janë dhënë për transaksione në tregun e jashtëm dhe 4 vendime për transaksione në tregun e brendshëm. Transaksionet e autorizuara si përqendrim në tregun e brendshëm i përkasin: përfutimit të kontrollit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga shoqëria “EUROSIG” sh.a; përfutimit të kontrollit të shoqërisë “*Albchrome Holding*”; përfutimit të kontrollit të shoqërisë “*Energy plus*”; përfutimit të kontrollit të shoqërisë “Radio”.

Si pasojë e vendimmarrjes së Autoritetit, referuar kontrollit të përqendrimeve, rezulton se është arkëtuar në buxhetin e shtetit vlera prej 16,7 milionë lekësh, nga 12,4 milion dhe 13 milionë lekë të arkëtuar respektivisht në vitet 2020 dhe 2019. Gjithashtu, autoriteti ka miratuar 28 vendime, që lidhen me zbatimin e dispozitave ligjore për marrëveshjet e ndaluara, nga 7 vendime që janë miratuar në vitin 2020.

Ndër të tjera janë miratuar 16 vendime nga 7 vendime të miratuara në vitin 2020 për zbatimin e dispozitës ligjore të nenit 9 për abuzimin me pozitën dominuese në treg, ku mund të veçojmë: mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të gazit të lëngshëm, duke vendosur detyrime për ndërmarrjet koncesionare,; mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve pa gjetje të procedurës së hetimit; hapjen e hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të *Tirana International Airport*.

Gjithashtu, është përafrimi i mëtëjshëm i kuadrit rregullator të konkurrencës me direktivat e BE-së, duke hartuar dhe duke miratuar gjatë vitit 2020 2 akte nënligjore në formën e udhëzuesit që do t'u vijne në ndihmë të ndërmarrjeve, konsumatorëve dhe publikut në tërësi për sa u takon çështjeve që lidhen me praktikën më të mira në rastet e zbatimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve dhe për dorëzimin e provave me karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave në rastet kur kanë të bëjnë me marrëveshjet e ndaluara dhe abuzimin me pozitën dominuese në treg; dhënia e kontributit për institucionet e tjera për sa i takon hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore, ku për vitin 2020 Autoriteti Konkurrencës ka vlerësuar në total 36 akte dhe projektakte, nga të cilat 30 projektakte në tregun e energjisë dhe gazit (projektligje), 2 projektakte në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura lidhur me ndryshimin e nivelit tarifor, si dhe dhënien e rekomandimeve për disa akte nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik, koncesioneve dhe shërbimit të auditimit ligjor; trajnimi i vazhdueshëm i stafit i realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet projekteve të BERZH-it dhe IPA-s, si dhe OECD, ICN, etj, duke bërë të mundur zhvillimin e 68 trajnimeve virtuale brenda dhe jashtë vendit si dhe 1 vizite studimore.

Janë ndjekur 20 procese gjyqësore gjatë vitit 2021, ku autoriteti rezulton të jetë i paditur nga ndërmarrjet, për të cilat me vendimmarrje të komisionit është konstatuar abuzimi me pozitën dominuese, ku në 14 raste Gjykata Administrative e Shkallës së Parë i ka dhënë të drejtë autoritetit. Vlen të përmendet që nga të 20 çështje gjyqësore të gjykuara në vitin 2021, 14 prej

tyre lidhen me vendimmarrje të vitit 2020 dhe vetëm 6 me vendimmarrje të vitit 2021 të komisionit. Janë marrë masa penalizuese ndaj kompanive, të cilat kanë shkelur dispozitat ligjore të përcaktuara në vendime të autoritetit; dhe i kemi të renditura në të gjitha materialet që kanë të gjithë kolegët e komisionit.

Për sa u përket disa rekomandimeve që duhen mbajtur parasysh në veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2022, pas një diskutimi të vazhdueshëm, me synim përmirësimin e aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës kemi renditur: së pari, të nxitet komunikimi më i mirë me publikun në tërësi nëpërmjet publikimit të *Newsletter*-it mujor të autoritetit; të përmirësojë treguesit e transparencës për vendosjen në dispozicion të qytetarëve të një kategorie më të gjerë të informacionit; të paraqesë informacion të detajuar vjetor për ndryshimet në përbërjen dhe organizimin e stafit të sekretariatit; të angazhojë kapacitetet administrative të institucionit për intensifikimin e monitorimeve dhe përfundimin në një kohë të arsyeshme të procedurave hetimore jo vetëm në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë për mirëqenien e konsumatorit, por edhe në tregjet e tjera, referuar rekomandimeve të BE-së dhe OECD-së, si tregu i medias audiovizive dhe sektori i platformave digjitale; të përfshijë sa më parë ndryshimet për rishikim e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, në procesin e konsultimit publik, me qëllim paraqitjen e tyre në Kuvend brenda vitit 2022; të angazhojë kapacitetet e tij administrative për adresimin e rekomandimeve cilësore për entet rregullatore dhe institucionet e administratës qendrore, si dhe për pasurimin e platformës parlamentare *online* me këto rekomandime, duke përditësuar statusin e tyre në vazhdimësi; të përfshihet më shumë në advokacinë e reformave që promovojnë konkurrencën në procedurat e prokurimit publik, si dhe të organizojë tryeza në këto fusha për autoritet kontraktuese dhe për bashkësinë e biznesit, në mënyrë që të udhëzohet drejt hartimi optimal të procedurave të prokurimit publik; të fokusohet për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës në botën akademike, me qëllim sigurimin e njohurive të nevojshme për shumë profesionistë në fushën e ligjit dhe të ekonomisë së konkurrencës për të trajtuar politikatat e konkurrencës dhe çështje të rregullimit të tregut.

Në linja të përgjithshme, ky ishte vlerësimi për aktivitetin e autoritetit të konkurrencës për vitin 2021 dhe disa rekomandime për vitin 2022. Besoj se gjatë diskutimeve që do të kemi dhe seancës pyetje- përgjigje do ta pasurojmë këtë raport në formatin përfundimtar për t’i kaluar seancës parlamentare për miratim.

Faleminderit!

Eduard Shalsi- Faleminderit, zonja Gjylameti!

Përpara se t'ia kaloj fjalën zonjës Koti dua t'ju them që kemi marrë një vendim që për institucionet e pavarura të vendosim një precedent të ri, ku relatorët do të jenë dy, një nga pozita dhe një nga opozita.

Zonja Koti, fjala për ju.

Sorina Koti- Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë Autoritetit të Konkurrencës,

Ju prej kohësh jeni vënë në shënjestër për shkak të rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore dhe të çmimeve të naftës dhe tregut energjetik. Ne, si opozitë, kërkuam me ju një dëgjese, të cilën e morëm me shumë vonesë përgjigjen për dëgjuesin në Komisionin e Ekonomisë. Raportin që keni paraqitur për të vlerësuar punën tuaj si institucion në vitin 2021 unë e kam lexuar dhe ka ende detyra, të cilat janë të paplotësuara ose të papërbushura sipas ligjeve që ju operoni nën varësinë e Kuvendit të Shqipërisë. Kështu që unë do të doja t'ju inkurajoja për të vazhduar punën hetimore që keni nisur për shumë çështje me interes publik dhe më pas të ngre problemet, të cilat mungojnë në raportin e vitit 2021. Në radhë të parë, mungojnë amendimet të ligji për mbrojtjen e konkurrencës të vitit 2021, për amendimin e ligjit nr. 9121 dt. 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" të ndryshuar". Ne do të donim arsyet vonesës së amendimit të ligjit dhe pse grupi i punës është ngritur në muajin janar të vitit 2022 dhe jo më parë.

Një tjetër çështje tjetër me interes, që mungon në raport dhe që i intereson shoqërisë civile dhe qytetarëve shqiptarë janë hetimet në tregun e importit të grurit dhe prodhimit dhe tregtimit të miellit. Çmimet janë rritur ndjeshëm, ne kemi pasur një seancë dëgjimore enkas për këtë situatë dhe problematikë dhe ju ndoshta mund të na informoni më shumë rreth kësaj situatë.

Një problem tjetër është ngritja, prodhimi dhe tregtimi me shumicë në tregun e importit të vajit vegjetal dhe tregut të menaxhimit të faciliteteve të parkimit të TIA-s. Ku janë hetimet deri tani, çfarë ka ndodhur dhe konkluzionet dhe masat përfundimtare që do t'ia paraqisni kuvendit?

Një tjetër gjetje që mungonte te raporti juaj është prodhimi dhe tregtimi i naftës bruto. Sa është masa e detyrimeve të kompanisë Bankers Petrol?

Një tjetër hetim që i mungon raportit është vlerësimi në tregun e shërbimeve bankare. Si është situata pas konsolidimit të tregut dhe a kemi një pozitë dominuese të bankave shqiptare në treg?

Inputet bujqësore kanë qenë një problem i ngritur dhe i shoqëruar me protesta të fermerëve në Shqipëri. prandaj ne duam të dimë masat që ju keni marrë në zhvillimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore, sepse e dimë që jemi një vend bujqësor industrial, ku prioritet ka sektori i bujqësisë si mënyrë për të rritur produktin e brendshëm bruto.

Një problem tjetër janë 20 çështjet që ju keni trajtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë. Sa prej tyre janë në favor të Autoritetit të Konkurrencës dhe sa prej tyre nuk janë? Ndoshta mund të na jepni një informacion më tepër në komision edhe për praktikatat që ju keni apeluar.

Për sa u përket prioriteteve që ju keni vendosur në raportin për vitin 2022, a ka ndonjë rishikim të prioriteteve, duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në ekonomi, sektorët e saj, sidomos tregun energjetik të naftës dhe tregun e drithërave.

Përveç problematikave që zonja Gjylameti ngriti, unë dua që të shtoj edhe disa të tjera, siç është zgjatja në kohë e procedurave hetimore. Ndoshta këtu mund të kemi një diskutim, pasi kjo zgjatje vjen për shkak të moskoordinimit të autoritetit të konkurrencës me institucionet e tjera për të marrë në kohë informacionin. Nëse mungon digjitalizimi i protokollit, i arkivave dhe komunikimit me këto institucione, në mënyrë që të mos zgjaten hetimet, sepse në momentin që ju jepni një vendim ka kaluar edhe koha e ngjarjes. Nëse është eficient stafi juaj, kërkoni më shumë staf apo munda të kemi një lloj rritje të eficiencës së stafit, duke e diskutuar në komision dhe çfarë mund të ndihmojmë ne si Komision i Ekonomisë për ta bërë punën tuaj sa më eficiente. Ju keni vende vakante në Autoritetin e Konkurrencës, gjë që do të krijojë një pengesë për mbledhjen tuaj në muajt në vazhdim, nuk mblidheni sipas ligjit, në mënyrë që të monitoroni tregun sipas procedurave. Mund të keni problem edhe me publikimin e vendimeve në kohë dhe transparent me botimet, gjë që e kemi hasur pothuajse në të gjithë raportin. Kështu që në vlerësimin tim, si relatore e opozitës, dua t'i kërkoj më shumë transparencë edhe për konfliktin e interesit, të jeni sa më të hapur ndaj shoqërisë civile, botës akademike, biznesit dhe institucioneve të tjera qeveritare, në mënyrë që hetimi të kryhet në kohë dhe të marrim përgjigje reale se çfarë ndodh me tregje, të cilat ne kërkojmë informacion, si dhe të kemi takime më të shpeshta të Autoritetit të Konkurrencës me Komisionin e Ekonomisë sipas kërkesave që mund të kemi për shkak të situatës ekonomike të rënduar.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Koti!

Sikundër konstatuat, ka elemente të relativit, por ka edhe komente dhe pyetje dhe, përpara se t'ua jap fjalën kolegëve deputetë për pyetje, dua të di nëse keni komente se çfarë u tha nga relatorët, apo doni të vijojmë me pyetjet?

Denar Biba- Mund t'i ezaurojmë disa nga pyetjet.

Eduard Shalsi – Dakord, zoti Biba.

Denar Biba- Disa nga shqetësimet janë të njëjtat si të relatores, zonjës Gjylameti, ashtu edhe zonjës Koti. I falënderoj të dyja relatorët!

U përmenden vendime të papublikuara në afat dhe dua të ndaj me ju disa praktika, pse jo edhe taktika të punës së Autoritetit të Konkurrencës. Disa nga vendimet tona, kryesisht ato po çeljen e hetimeve, nuk publikohen me vetëdije menjëherë ditën apo të nesërmen e marrjes së vendimit, sepse do të cenohet elementi surprizë, që është element shumë i rëndësishëm në hetimet e kësaj kategorie. Ne, menjëherë pas marrjes së vendimeve, jepen autorizimet, ngrihen grupet përkatëse me inspektorët, shkojnë në ndërmarrjen përkatëse, natyrisht, me shpresën për të mos gjetur asgjë të keqe, por me qëllimin për t'i gjetur problematikat në shkelje të ligjit të konkurrencës, duke qenë se ne kemi pasur dyshime të arsyeshme kur kemi hapur hetimet përkatëse. Një pjesë të këtyre vendimeve ne nuk mund t'i publikojmë, pikërisht, për të mos u cenuar ne në punën tonë.

Një pjesë e vendimmarrjes tonë ka të bëjë edhe me përqendrimet. Ne kemi dy kolona të mëdha: anti trust-i dhe përqendrimeve, anti trust-i ndahet në abuzime me pozitën dominuese dhe marrëveshje e ndaluara dhe përqendrimet.

Lidhur me përqendrimet, sikundër tashmë u tha edhe këtu, ne arkëtojmë për buxhetin e shtetit, duke qenë se përqendrimi është kundrejt fee-ve, pagesave të caktuara dhe pa u bërë derdhja në buxhetin e autoritetit ne nuk e nxjerrim vendimin, në mënyrë që të mos i krijojmë vetes problematika për marrjen e pagesës. Pra, presim deri s atë bëhet pagesa dhe vetëm atëherë i japim vendimin dhe e publikojmë atë.

Një tjetër problematikë, e cila lidhet me pamundësitë tona lidhur me administratën, është se kur ne i nxjerrim vendimet, ose vendimet që janë në faqen tonë, nuk janë vendimet ekzaktësisht që merren nga ne, por janë të anonimizuara, sepse ne i pastrojmë nga sekretet hetimore, ose nga të dhëna të tjera, të cilat janë konfidenciale. Nëse ju do të hyni te faqja, nuk do të gjej gjithçka nga vendimet, sepse kjo kërkon një lloj pune të specializuar, e cila kërkon kohë.

Kjo nuk e justifikon faktin që në ndonjë rast të kemi pasur edhe ndonjë vendim të hedhur në kohë, por doja t'ju shpjegoja disa problematika që lidhen me specifikën e institucionit.

Të dyja zonjat thonë që konflikti i interesit të anëtarëve nuk bëhet prezent në kohë. Në fakt, sa herë që ka qenë, të paktën sa kujtoj unë nga viti 2021, në të gjitha rastet që ndonjë nga anëtarët e ka gjetur veten në dukje apo realisht në konflikt interesi në procesin vendimmarrës... Mbledhja e Autoritetit të Konkurrencës nis me pyetjen ose me krijimin e vetëdijes në lidhje me pikën specifike të rendit të ditës, nëse ka ndonjë koleg në konflikt interesi, dhe ata përgjigjen me po ose jo dhe vijon mbledhja me kolegun hipotetik, i cili është larguar. Ka pasur vetëm një rast dhe është çdo gjë në procesverbal. Pse nuk e kemi hedhur në faqen zyrtare?! Nuk di ta them këtë. nuk ka pasur një praktikë më të hershme dhe nuk ka ndodhur ndonjëherë kështu, por, fare mirë, mund të jetë një praktikë, të ciklën mund ta ndryshojmë dhe , me atë rast, çdo vendim të identifikohet edhe nga publiku. Kjo në kuadër të transparencës, që ky vendim është marrë nga 4 anëtarë dhe jo nga 5, sepse njeri prej tyre ka qenë në konflikt interesi. Në këtë pikë, unë do të doja, i nderuar kryetar dhe të nderuar deputetë, sillja në vëmendjen tyre edhe faktin që prej disa kohesh ne vazhdojmë të jemi 4 anëtarë dhe nuk po plotësohemi, madje edhe nga këta 4 anëtarë, njëri kolege i ka mbaruar mandati. Ligji parashikon që ne qëndrojmë në detyrë deri në zëvendësimin tonë, por kjo nuk ka qenë zgjedhja e ish-anëtares, e cila vlerësoi që të mos vinte më përfundimisht, është zgjedhje e zonjës Matja për të qëndruar në detyrë dhe ne vazhdojmë të jemi me 4 anëtarë, që është numri minimal për të çeljen e seancës. Ne nuk çelim dot seancën me atë numër anëtarësh e jo të marrim vendime. Në një rast të afërt, të pritshëm ne serish mund të biem në një situatë konflikti interesi, një ose dy prej nesh. Jemi në një farë moshe, që për fat të mirë nënkupton eksperiencë profesionale, por, nga ana tjetër, kjo ka bërë që në rrugëtimin tonë profesional të jetës të kemi pasur edhe marrëdhënie m e të tretë, gjë që mund të na vërë në pozita të caktuara në konflikt interesi lidhur me këtë detyrë, qoftë edhe në dukje. Prandaj, dua t'ju lutem të bëni të mundur të ushtroni ndikimin e nevojshëm në mënyrë që institucioni të plotësohet edhe me kolegun e ardhshëm, mundësisht, rinovimin e mandatit të zonjës Matja apo plotësimin me një koleg tjetër.

Procedurat në kohë. Disa hetime tona thuhet që zgjasin. Në fakt ka një shprehje në komunitetin e ekspertëve të konkurrencës, të cilët literalisht thonë se hetimet e agjencive të konkurrencës nuk janë mujore, por janë vjeçare dhe shembujt që ne i mësojmë edhe në trajnime, ato shembujt që përbëjnë realisht gur në jurisprudencën e konkurrencës botërore, si nga CMA-ja

britanike, si nga komisioni apo nga të tjerë janë hetime që kanë zgjatur minimalisht dy vjet, por edhe 4, edhe 8 apo 10 vjet, veçanërisht nëse synohet të gjenden marrëveshje të ndaluara, ato që konsiderohen të fshehta, sepse tashmë ne nuk i evidentojmë dot më dhe janë shumë të rralla ato që evidentohen me prova konkrete, por gjithmonë evidentohen me prova indirekte, rrethore, kryesisht të karakterit ekonomik, përmes analizave realisht të stërholluara, algoritmeve, teorive të lojë, të gjitha kërkojnë kohë. Prandaj, edhe për këtë arsye legjislatori shqiptar nuk ka parashikuar afate në lidhje me hetimet e komisionit të konkurrencës deh se kur duhet të dalë një vendim. Hetimet zgjasin, kjo nuk na justifikon asnjë lloj rrethane, por kështu është.

Në lidhje me hetimin në tregun e importit të grurit, miellit ne kemi mbajtur një dëgjese të tërë, disa orë këtu, nëse doni i rikthehem prapë, por hetimi më tregun e vajit vegjetal, në TIA-n, lidhur me naftën bruto janë hetime në proces. Praktikisht, ato zhvillohen nga sekretariati. Ju e dini tashmë që është përvojë pune e të gjithë autoriteteve, ose shumicës së autoriteteve të konkurrencës deh sugjerim nga OECD-ja që strukturat e Autoriteti të Konkurrencës të jenë të këtij karakteri të ngjashëm, prokurë-gjykatë, ku hetimi zhvillohet nga sekretariati dhe komisioni pret si një gjykatë në përfundim të hetimeve. Këto janë nën hetim këto çështje, kështu që nuk mund t'ju jap informacion të mëtejshëm.

Lidhur me çështjet në gjykatë, të gjitha vendimet tona, pothuajse, janë ankimuar. Edhe këto të fundit fare për gjobat, të cilat morën një publiciteti, nuk na gëzon ky lloj publiciteti, por, sidoqoftë, janë ankimuar. Dje, nëse nuk gabohe, është marrë pezullimi i akti administrativ të vendimit të komisionit të konkurrencës në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Prioritetet tona janë ato që shqetësojnë shoqërinë shqiptare. disa prej tyre janë vendime të dala apo rekomandime të ardhura përmes rezolutës së Kuvendit, disa përmes ankimeve që paraqiten në Autoritetin e Konkurrencës dhe disa hetime janë hetime të nisura ex officio, natyrisht, reflektojnë asgjë më shumë sesa interesat e shoqërisë.

Lidhur me vendet vakante, ne nuk kemi asnjë vend vakant, aktualisht, në Autoritetin e Konkurrencës, përkundrazi, do të donim shtim të kapaciteteve tona, aq më tepër, sikundër e keni edhe në progresraportin e BE-së për Shqipërinë, është lënë prej disa vitesh rresht detyrim forcimi i strukturës shqiptare që monitoron dhe autorizon ndihmën shtetërore. Ndihma shtetërore është shumë natyrore të jetë pranë Autoritetit të Konkurrencës. Nëse, realisht, shteti shqiptar, Kuvendi apo qeveria do të krijojnë një strukturë permanente të ndihmës shtetërore, nuk ka se ku ta gjej më

të specializuar sesa një institucion i pavarur, i ngritur me vendim të parlamentit, me një ligj të posaçëm, sikundër është Autoriteti i Konkurrencës.

Këto ishin përgjigjet që doja të jepja në respekt të fjalës së dy zonjave.

Eduard Shalsi- Ju thatë që jeni në fazën e hartimit të ligjit të ri për konkurrencën dhe besoj se do të jetë një moment i mirë kur të diskutojmë edhe me Ministrinë e Financave, pranë së cilës është edhe ndihma shtetërore.

Denar Biba- Praktikisht, kam zhvilluar një takim me ministren. ministrja është dakord, por mua nuk më takon ta them ekzaktësisht këtë fjalë këtu, por nuk na ka ardhur zyrtarisht kjo gjë. Edhe Kryenegociatori, zoti Mazi, është vënë në dijeni dhe ka marrë një projekt tonin, i cili, apriori, është shprehur pozitivisht për këtë, por ende nuk kemi diçka me shkrim. Kështu që le të mbetet e thënë me fjalë dhe në besim të një dakordësie midis nesh, sepse ende nuk kemi marrë një përgjigje në kuadër të ndonjë studimi në lidhje me këtë.

Eduard Shalsi- Para se të kalojmë te pyetjet e kolegëve, një pyetje e drejtuar me shkrim Autoritetit lidhur me rekrutimet e reja, largimet e reja përgjatë viteve 2017-2018-2019-2020 dhe 2021. Informacionin e keni të gjithë në *google drive* që e kemi *share*.

Në vitin 2017 në organikë kanë qenë 39 punonjës , janë zhvilluar 7 procedura rekrutimi dhe 2 punonjës të larguar me dëshirë.

Në vitin 2018 në organikë kanë qenë 43 punonjës, janë zhvilluar 8 procedura rekrutimi dhe janë larguar 8 punonjës, 7 të larguar me dëshirë, 1 është larguar me masë disiplinore.

Në vitin 2019 në organikë kanë qenë 46 punonjës, janë zhvilluar 8 procedura rekrutimi dhe janë larguar 5 punonjës, 4 janë larguar me dëshirë dhe 1 ka dalë në pension.

Në vitin 2020 në organikë kanë qenë 46 punonjës, 9 procedura rekrutimi dhe 1 punonjës ka dalë në pension.

Në vitin 2021 kemi 5 punonjës të larguar, 3 janë larguar me masë disiplinore, 1 ka dalë në pension dhe 1 është larguar me dëshirë.

Ndërkohë, pyetja e kolegut ishte: sa është mesatarja e viteve të punës në Autoritet për të gjithë punonjësit, përgjigjja është 7 vjet. Kjo ishte e vetmja pyetje e drejtuar me shkrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, fjalën e ka zonja Dhima, pastaj zonja Tabaku.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit zoti Biba për prezantimin e veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2021, njëkohësisht edhe përfaqësuesve të këtij Autoriteti që janë prezent në këtë dëgjese! Unë kam disa pyetje.

E para, a keni ju personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar, në mënyrë që Autoriteti i Konkurrencës të zhvillojë një hetim të hapur, për të dhënë vendime në lartësinë dhe pritshmërinë që ka Kuvendi i Shqipërisë dhe qytetarët?

E dyta, hetimet e kryera nga Autoriteti i Konkurrencës normalisht që zgjasin me muaj të tëra dhe ata që drejtohen këtij institucionit tuaj për shqetësimet që ata përcjellin, qofshin biznese, institucione apo qytetarë e humbasin interesin. A keni ju një shpjegim në lidhje me këtë problematikë?

E treta, Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar një proces të gjatë për rishikimin e ligjit organik të funksionimit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, i cili është në fuqi dhe ju funksiononi në bazë të këtij ligji. Ligji është rishikuar dhe është përfshirë edhe në institucione qendrore dhe të pavarura, por edhe në palë të treta, si Dhoma e Tregtisë, studiot ligjore, shoqatat e biznesit, të cilat kanë dhënë mendimin e tyre. Ajo që dua të di është: a janë reflektuar në këtë draft të gjitha shqetësimet, sipas rezolutës së Kuvendit, dhe problematikat që ju si institucion keni hasur gjatë punës suaj?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Atëherë, do të marrim të gjitha pyetjet nga deputetët, pastaj do të përgjigjeni.

Fjalën e ka zonja Tabaku, pastaj zoti Leskaj.

Jorida Tabaku – Të nderuar anëtar të Autoritetit të Konkurrencës,

Zoti Biba ngriti një shqetësim që do ta ngrija edhe unë. Për momentin Autoriteti i Konkurrencës ka dy pozicione që nuk janë të plotësuara, zonja Matja dhe zonja Latifi. Të dyja pozicionet janë propozime të Këshillit të Ministrave, por maxhoranca e prishi balancën kur propozoi zotin Biba, që duhet të ishte një propozim i opozitës. Për këtë arsye unë gjykoj që, që në momentin e parë të vendoset balanca e këtij institucioni, duke siguruar edhe përfaqësimin e opozitës në këtë komision, për shqetësime, siç tha edhe zoti Biba me të drejtë, ka njohje me palë të treta dhe mund të ketë konflikt interesi. Pra, nësi komision duhet të sigurojmë vendimmarrjen e këtij institucioni shumë të rëndësishëm, që, për arsye edhe të situatës që po përjeton në tregun shqiptar, ka një rëndësi jetike edhe për këtë komision.

Kam dy elemente që dua t'i theksoj.

Elementi i parë, zoti Biba gjatë prezantimit të tij foli gjatë për detyrimet që lë progresraporti i fundit, nga pikëpamja e përfrimit të legjislacionit ju u bazuat kryesisht te përfrimi i legjislacionit, ndërkohë që unë jam e interesuar për të drejtat ekskluzive. Në progresraport thuhet: "Autoriteti duhet të jetë më aktiv në kontrollin paraprak të PPP-ve dhe të drejtave ekskluzive që atyre mund t'i jepet dhe njëkohësisht në kontrollin e përputhshmërisë me parimet e konkurrencës me të gjithë instrumentet ligjore të përdorura për koncesionet, përfshirë marrëveshjen ndërqeveritare të lidhura me vendet e treta për zbatimin e projekteve të përbashkëta".

Kemi ngritur shqetësim herë pas here në lidhje me ofertat e pakërkuara për sa u përket autoriteteve publike private.

Kemi ngritur shqetësim për sa u përket përqendrimeve dhe të drejtave ekskluzive, të cilat janë dhënë me ligje të veçanta nga qeveria.

Kemi ngritur shqetësim për faktin se një pjesë e madhe e tenderëve publikë janë të përqendruar në një grup të vogël kompanish, duke prishur konkurrencën, por duke krijuar një përqendrim të punëve publike në një grup të vogël kompanish.

Unë kam ngritur një shqetësim për aeroportin e Vlorës, për të cilin ju keni bërë një hetim. Në gjykimin tim nuk ka qenë një hetim i plotë, sepse nuk arriti të jepte atë që duhet të jepte hetimi. Orientimi i këtij shqetësimi është dhënia e një të drejte ekskluzive një kompanie, ndërkohë që ju keni dalë me sugjerime për sa u përket tarifave që do të ketë kjo kompani në të ardhmen.

Kam edhe një shqetësim real për portin e Durrësit, i cili futet në këto të drejta ekskluzive.

Dua të di rolin e Autoritetit të Konkurrencës në hetime për sa u përket partneriteteve publike-private, vendimeve që keni marrë, sugjerimet që janë dhënë, përqendrimet e tenderëve të qeverisë, të drejtave ekskluzive që sot po jepen me ligje të veçanta, si porti i Durrësit dhe aeroporti i Vlorës, të cilat janë dhënë me ligj të veçantë, që përbëjnë interes për sa i përket progresraportit, meqenëse e cituat, sepse shkelin edhe MSA-në. Pra, të dy këto tenderë kanë shkelje të konkurrencës dhe shkelje të drejtëpërdrejtë të Marrëveshjes së Sabilizim-Asociimit.

Në raport ju përmendni një hetim për sa i përket vajit vegjetal, i cili është përfunduar në maj të vitit 2021. Keni vënë re rritje të çmimit, ndërkohë që rritja e çmimit ka vazhduar në muajt e parë të vitit dhe shqetësimi në këtë rast është për konsumatorët. Për shqetësimin e konsumatorit

për sa i përket tregut të vajit vegjetal, por edhe për të gjitha produktet e tjera të shportës (këtu nuk po merrem me çështjen e miellit, për të cilën kemi bërë një dëgjësë të veçantë pas tre muajsh, pasi e kërkuam, sepse këtu duhet përmendur edhe tregu i grurit, i cili ka problematika që në gjykimin tim Autoriteti i Konkurrencës ka mangësi në hetimin e plotë të këtij tregu, duke pasur parasysh edhe dinamikat e muajve të fundit), nuk ka akoma asnjë veprim konkret.

Shqetësimi për rritjen e të gjitha produkteve, sidomos të produkteve të shportës, besoj se duhet të ishte, siç na thatë ju kur ishit herën e fundit, jetik për sa u përket qytetarëve dhe domosdoshmëri e nevojës së parë për sa i përket Autoritetit të Konkurrencës në shërbim të funksioneve ligjore për të cilat është ngritur dhe funksionon.

Për sa u përket hetimeve të tregut të hidrokarbureve, ka një hetim për “Bankers Petroleum”.

Zoti kryetar, besoj se në situatën në të cilën ndodhet tregu i hidrokarbureve, është në interes të këtij komisioni, që bashkërisht me hetimin që do të ketë Autoriteti i Konkurrencës, të kemi një informacion të plotë nga Drejtoria e Tatimeve për sa i përket situatës për “Bankers Petroleum”.

Duke parë atë që po ndodh sot në tregun e hidrokarbureve, ku rritet çmimi i karburantit në treg pa u rritur çmimi i bursës, të mos flasim për shpikjet alla-komunizëm të bordeve që caktojnë çmime, përpara vendosjes së këtij bordi, ky duhet të ishte shqetësimi real i parë i Autoritetit të Konkurrencës, i cili duhej të ishte përgjigjur nevojave të qytetarëve dhe të tregut. Unë kam nevojë për më shumë informacion në lidhje me këtë.

Në vitin 2015 Autoriteti i Konkurrencës ka kryer një hetim të thelluar për sa i përket tregut të hidrokarbureve, janë dhënë disa rekomandime, ka disa udhëzime, të cilat në gjykimin tim nuk po zbatohen. Çfarë roli po luan Autoriteti i Konkurrencës në këtë drejtim?

Unë e pashë listën që citoi zonja Gjylameti, por njëkohësisht e citoi edhe zoti kryetar, të 12 tregjeve që janë nën hetim, pavarësisht rëndësisë që mund të ketë, për shembull, tregu i produkteve “*plays tation*” apo tregu i blerjeve të përqendruara publike për tonera dhe bojëra, gjykoj që, ju keni një kudër ligjor në të cilin bazoni punën tuaj, mund të nisni një monitorim apo një kërkim bazuar edhe në kërkesat e tjera që ndoshta janë të pavarura. Pra, Autoriteti i Konkurrencës gjykoj se duhet të jetë më proaktiv në nisjen e hetimeve të pavarura që vijnë dhe nga palë të treta, duke pasur parasysh interesin qytetar.

Kam edhe shqetësim, me të drejtë janë bërë 94 vendime në total dhe kemi një rritje nga viti paraardhës dhe nga dy vjet më parë, por që është vendosur vetëm një gjobë. Shqetësimi im është në cilësinë e vendimeve që merr Autoriteti i Konkurrencës. Ju sapo na njoftuat, unë nuk kisha dijeni, që është vendosur pezullimi edhe mbi gjobat që janë marrë. Për shembull, për sa i përket rastit të plehrave kimike, i cili bëri bujë dy javë më parë kur u morr ky vendim. Pra, shqetësimi është: vendimmarrja e Autoritetit të Konkurrencës a është cilësore në këtë rast? Kur në 94 vendime kemi vetëm një rast gjobe, ku në të gjitha tregjet që unë përmenda ka shqetësime reale, ngrihet një pikëpyetje për sa i përket çështjes së vendimmarrjes së Autoritetit të Konkurrencës. Besoj këto janë disa nga shqetësimet.

Unë dhe zoti Shalsi duhet të jemi në një mbledhje tjetër, por për shkak të interesit që ka kjo mbledhje vendosa të dëgjoj përfaqësuesit e Autoritetit të Konkurrencës

Kam edhe diçka të fundit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thashë që kam një mbledhje tjetër, por do të qëndroj deri në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe një shqetësim të fundit për sa i përket hetimit që keni pasur për pozitën dominuese të gazit, për Portin e Durrësi dhe të Vlorës, për shoqëritë “Romano Port sh.a.”, “Porti MBM” dhe “PIA sh.a.”.

Ju në vendimin dhe në rekomandimet tuaja përmendni mosvendosjen e çmimeve në mënyrë diskriminuese për sa u përket kompanive të gazit, a ka informacione që janë vendosur çmime dhe çfarë situatash të tilla ka pasur në të dyja rastet? Këtë e lidh me çështjen e parë që ngrita, e cila lidhet me të drejtat ekskluzive për koncesione dhe partneritete publike-private, veçanërisht të drejta ekskluzive të dhëna nga qeveria për sa u përket porteve, sepse dhënia e të gjithë porteve të vendit, por edhe aeroportit, të njëjtës kompani mund të ketë rezultuar në përcaktimin e çmimeve në këtë rast, pra nëse ka indicie, sepse nga raporti unë nuk arrij ta kuptoj se cila është situata e informacionit që është publikuar këtu.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Më fal, zoti kryetar, se erdha me vonesë, ne do të bëjmë pyetje apo edhe pyetje dhe komente?

Eduard Shalsi – Rregulli është që në fillim të bëjmë pyetje dhe pas përgjigjeve mund të bëhen komente. Nuk është se është respektuar plotësisht kjo, prandaj ju ftoj që ta ndajmë pjesën e pyetjeve me pjesën komenteve.

Bujar Leskaj – Unë jam përpjekur që pyetjet e mia t'i përqendroj te raporti që ka paraqitur Autoriteti i Konkurrencës dhe në ndonjë shtesë nga ato çfarë tha kryetari. Kam edhe një koment për një vlerësim të zonjës Tabaku, për të cilën kam një respekt konstant dhe të padiskutueshëm.

A ka arritur Autoriteti i Konkurrencës të sigurojë një partneritet real me komunitetin e biznesit të konsumatorit dhe të organizatave të shoqërisë civile, të fushës ekonomike përgjatë vitit 2021, për të zbuluar praktikant antikonkurrese në tregjet e hetuara deri tani dhe ato të pahetuara?

A ka përjetuar Autoriteti i Konkurrencës në kryerjen e detyrave dhe hetimeve të tij ndërhyrje dhe influenca të papërshtatshme nga struktura shtetërore dhe politike?

Te fjala e kryetarit të Autoritetit më bëri përshtypje një kompleks, pra plani dhe propozimi për ndryshimin e ligjit është konsultuar me ministrin e Financave me kryenegociatorin e të tjera, që tregon një kompleks inferioriteti ndaj qeverisë. Në nenin 18 thuhet se ju jeni organ publik i pavarur dhe konsultimet në radhë të parë duhet t'i keni me Kuvendin e Shqipërisë dhe veçanërisht me këtë komision.

Pyetja e tretë, sa aktiv ka qenë Autoriteti i Konkurrencës në kryerjen e aktiviteteve me të tretë dhe ndërmarrjen e fushatave informuese të adresuara për biznese, shoqatat e biznesit dhe studiot ligjore që ofrojnë asistencë ligjore për bizneset?

Pyetja e katërt, që ndoshta lidhet me të dytën, a ka zhvilluar Autoriteti i Konkurrencës fushata informuese dhe sensibilizuese në medie tradicionale dhe atë sociale për të forcuar efektivitetin e zbatimit kombëtar të masave antikartel apo antimonopol të ndërmarra prej tij?

Pyetja e pestë, në vijim të diskutimeve të zhvilluara një seancë më parë me Autoritetin e Konkurrencës, a e gjykon Autoriteti se neni 30, ruajtja e konfidencialitetit dhe e sekreteve tregtare, të ligjit tuaj organik për mbrojtjen e konkurrencës, pengon realizimin e plotë të misionit monitorues, ndihmues kontrollues të komisioneve dhe anëtarëve të Kuvendit ndaj punës dhe rezultateve të Autoritetit, por më tepër të institucioneve të tjera që ka në raport me ndërmarrjet tregtare të tilla si: organet tatimore, doganore e të tjera, me qëllim që edhe ne si Kuvend të jemi në sinergjizim të plotë me punën dhe veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës?

Unë për këtë qëllim në fakt kam përgatitur edhe një propozim për një ndryshim në nenin 30, pra atë të drejtë që ligji ia njeh që Autoriteti t'u japë informacion gjykatave, kam një shtesë edhe për anëtarët e Kuvendit të Komisionit të Ekonomisë e të tjera.

Raporti në formën e paraqitur, por besoj edhe në përmbajtje, është një raport i përgatitur me një strukturë moderne, për mendimin tim, është i thjeshtë në lexim, është i plotë, i bazuar në kritere shkencore, pra është për t'u marrë shembull. Por kam edhe një sugjerim. Ju mund t'i plotësoni shtojcat, të cilat mund të flasin më shumë. Ju keni paraqitur një tabelë, "Plani i Autoritetit të Konkurrencës 2022 – 2023 – 2024" dhe për këtë jeni për t'u përgëzuar, por mendoj se më shumë se një tabelë ajo duhet të jetë një shtojcë e plotë, pra një material përmbledhës për planet tuaja.

Ta bëj edhe vërejtjen miqësore për Joridën. Nuk diskutohet vlerësimi im për ju por ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua ta them dy herë, është e drejta ime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti ke folur për produktet bujqësore 1001 herë, do të flasësh edhe sot 1002 dhe bën shumë mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është shumë e rëndësishme për institucionin. Ne Autoritetin duhet ta inkurajojmë, nuk duhet ta dekurajojmë. Nuk vlerësohet puna e Autoritetit nga vendimet që marrin gjykatat, të cilat ne i dimë si janë. Edhe mua, formati si deputet, nuk më lejon të komentoj vendimet e gjykatave, por nga ana tjetër kjo nuk më bën që të mohoj punën e Autoritetit dhe të tregohem skeptik. Përkundrazi, Autoriteti duhet të vazhdojë punën. Eficienca e Autoritetit nuk matet aty, por se sa i besueshëm do të jetë për biznesin, për ndërmarrjet tregtare, sa i besueshëm do të jetë për qytetarët shqiptarë, të cilët kjo ngritje çmimesh po i fundos, sa i besueshëm dhe sa besim do të kenë qytetarët, bizneset e vogla e të mesme ndaj Autoritetit. Pra nuk matet puna nga 2 -3 gjykatës që marrin vendime.

Për sa i përket hetimit, koha është shumë e gjatë. Ju kryetar nuk mund të na tregoni se hetimet mund të jenë 2 apo 4-vjeçare, sepse ju duhet të vendosni një kufizim në ndërgjegjen tuaj profesionale që asnjë hetim të mos kalojë vitin.

Unë kam një koment për një hetim që keni bërë ju, por do ta bëj gjatë diskutimeve.

Eduard Shalsi – Dakord.

A ka kolegë të tjerë që duan të bëjnë pyetje? Jo, dakord.

Mund të vijoni me përgjigjet duke referuar edhe emrin e çdo deputeti që ka bërë pyetjet.

Denar Biba – Zonja Dhima pyeti nëse kemi personel të mjaftueshëm, në mënyrë që të jeni në lartësinë e asaj çfarë ju kërkon ligji, Kuvendi dhe shoqëria, unë po përfitoj të bëj një analizë të vogël në lidhje me një pyetje tjetër, që një koleg i nderuar ka bërë për ecurinë e rekrutimeve në Autoritetin e Konkurrencës. Nëse shikoni vitin 2017, ne kemi qenë 39 punonjës, këtu duhet të keni parasysh se në këtë numër përfshihen 5 anëtarët e komisionit, sekretarja e Përgjithshme e komisionit, e cila është historike në atë komision, dhe punonjësit mbështetës. Pra, praktikisht shkojnë rreth 32 punonjës të administratës, nga të cilët 21 janë larguar për arsye nga më të ndryshmet, për dalje në pension, për të kaluar në detyra të tjera apo të shkarkuar me masa disiplinore. Pra, nga viti 2017 vetëm 18 punonjës mbeten.

Ekspierienca e të tjerëve, paçka se në atë mesataren e dhënë përgjigje nga ne dhe që ju e vlerësuar që është, pak a shumë 7 vjet, kjo vjen kryesisht për shkak të eksperiencës shumë më të madhe të këtyre të tjerëve.

Një pjesë e personelit ka një periudhë kohore në autoritet prej vetëm 2-3 vjetësh, gjë që deri diku lë për të dëshiruar. Trajnimet në dy vjetët e fundit kanë qenë kryesisht *online*.

Unë mund ta them edhe nga eksperiencia ime si pedagog që mësimi *online* lë shumë për të dëshiruar dhe nuk është eficient, kështu që për këtë arsye edhe ne kemi kërkuar shtim të personelit.

U përmend këtu disa herë edhe nga dy relatorët tregjet e tipit digjital. Ne sot që diskutojmë me kolegët tanë ndërkombëtarë, tregjet digjitale janë sfida e viteve të fundit, të cilat kërkojnë struktura të posaçme pranë agjencive të konkurrencës, inxhinierë, IT, matematikanë, analistë, ndërtues algoritmesh, të cilët ne, praktikisht, nuk i kemi. Ne nuk e kemi një strukturë të tillë dhe, ndoshta, do të dojë kohë Autoriteti i Konkurrencës për ta krijuar një strukturë të tillë, duke pasur parasysh edhe se këto individë, për më tepër, kur kanë një eksperiencë të caktuar, janë tepër të paguar në sektorin privat, ndërkohë që pagat në institucionin tonë lënë realisht shumë për të dëshiruar, duke filluar që nga pagat e anëtarëve të komisionit, seriozisht lënë për të dëshiruar dhe nuk është turp të thuash që jemi të papaguar, ndërkohë që vendosim gjoba tepër të larta.

Meqenëse po ju dëgjoj që po diskutoni, paga e një anëtari (ne marrim edhe shpërblime për shkak të doktoraturave që kemi), por paga jonë është diku te 1 milion e 100 mijë lekë të

vjetër, që nuk nderon asnjërin palë dhe nuk e di përse nuk e nisni nga vetja vlerësimin dhe pse ndiheni të kompleksuar si deputetë të Kuvendit për të vendosur paga më të mira për zgjedhësit.

(Diskutime në sallë.)

Tjetër shqetësim ishte se hetimet zgjasin me muaj dhe humbasin interesin e ankuesve, profili i punës së një autoriteti konkurrence është shumë i ngjashëm me profilin e punës së një gjykate. Jo më kot nga gjithë literatura, ne konsiderohemi si një kuazi gjykatë, paçka se shpesh, në retorikën e përditshme, cilësohemi si rregullatorë, ne nuk jemi posaçërisht rregullatorë, jemi kryesisht kontrollorë, duke qenë se hetimet tona janë *ex-post*, pra *post-factum*.

Për këtë arsye, një pjesë e hetimeve vijnë edhe për shkak të ankimeve nga subjektet e interesuara apo për shkak të detyrimeve të lëna nga Kuvendi ose të nxitura *ex officio* nga institucioni dhe njëloj si në një gjykatë. Më duket e paarsyeshme që ne të funksionojmë dhe të jemi, natyrisht, vetëdija e kohës dhe e rrethanave. Kjo nuk na mungon, se ne nuk jetojmë jashtë realitetit, por fakti që hetimi merr kohë, tregon seriozitetin tonë për të mos dhënë nesër, pasnesër, vendime, të cilat do të jenë lehtësisht cenueshme nga gjyqësori, që është edhe kudhra fundore e vendimmarrjes. Pikërisht për këtë arsye ne marrim të gjithë kohën e nevojshme. Natyrisht, një pjesë e kohës është edhe për shkak të korrespondencave që kemi me institucionet shtetërore apo me ndërmarrjet private. Kërkon kohë edhe kjo gjë.

Në ndryshimet e ligjit ne do t'i propozojmë Kuvendit edhe akses të drejtpërdrejtë në databazat përkatëse të doganave apo tatimeve. Le të shohim se sa do të jetë e mundur kjo. Natyrisht, kjo do të kërkojë trajnim nga ana jonë, në mënyrë që të mos humbim në atë pyllin e të dhënave të databazave përkatëse.

Zonja Tabaku ngriti disa shqetësime, bëri edhe pyetje dhe një nga shqetësimet është në lidhje me rastet kur ndërmarrjeve private shqiptare u jepen të drejta ekskluzive si në lidhje me PPP-të apo koncesionet dhe cili është roli i Autoritetit të Konkurrencës.

Në dijeninë time, para 6-7 vjetësh, Autoriteti i Konkurrencës ka miratuar një formular, i cili u është shpërndarë autoriteteve shtetërore, dhe kjo është edhe në ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës", ku ju thuhet autoriteteve publike shqiptare që, sa herë ato miratojnë akte normative dhe vlerësojnë, në këtë rast e kanë më të lehtë përmes atij formulari, se ky akt normativ është i tillë që, qoftë edhe në dyshimin e tyre cenon apo mund të cenonjë ligjin "Për konkurrencën në Shqipëri" t'i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës.

Legjislatori shqiptar, me sa duket, e ka paraparë, jo të detyrueshme, por ua ka lënë autoriteteve publike në vullnetin e tyre, në vetëdijen e tyre profesionale, politike, qytetare, quajeni ju si të doni, për të angazhuar ekspertizën e Autoritetit të Konkurrencës.

Sa herë na është kërkuar kjo ekspertizë, ne e kemi dhënë. Në rastin e Aeroportit të Vlorës na është kërkuar, si dhe në dhjetëra raste të tjera nga entet e pavarura. ERE-ja, AKU-ja e të tjera na angazhojnë vazhdimisht, pothuajse të gjitha aktet e tyre vijnë për vlerësim pranë AK-së. Në lidhje me koncesionet, ai është i vetmi për momentin, duke qenë se flasim për vitin 2021. Aktualisht nuk kemi asnjë kërkesë.

Në lidhje me shqetësimet për rritjen e çmimit të vajit vegjetal, miellit të grurit, produkteve të shportës...

(Diskutime në sallë.)

Jorida Tabaku – Pyetja kishte, njëkohësisht, edhe përqendrimet në punët publike te një grupi të vogël kompanish. Dakord, qeveria ju nuk ju ka kërkuar mendim, ju ka kërkuar vetëm për aeroportin e Vlorës (në gjykimin tim edhe porti i Durrës është e njëjta praktikë, megjithëse është ligj special).

Pyetja vazhdonte për sa u përket punëve publike dhe përqendrimit të punëve publike në një grup të vogël kompanish, me vlerën maksimale të fondit limit (edhe prej eksperiencës suaj të mëparshme, besoj se ju e njihni si sektor), a ka AK-ja vetë hetime, monitorime, pavarësisht kërkesës së institucioneve për këtë çështje?

Besoj se ky është një shqetësim real që ne e shohim çdo ditë që ndodh, sidomos me projektet e mëdha, jo vetëm të koncesioneve, por edhe tenderimeve publike.

Denar Biba – AK-ja ka një plan të tij të punës, i cili është ngritur kryesisht në respekt të rekomandimeve të Kuvendit të RSH-së. Ne nuk jetojmë në ishull, por jetojmë në këtë realitet dhe pikërisht për këtë ne u përgjigjemi me shpejtësinë maksimale, në respekt të kapaciteteve që kemi, pa lënë mënjanë hetimet e tjera. Pikërisht për këtë arsye ne kemi nisur edhe hetimet menjëherë në tregun e vajit vegjetal dhe në tregun e hidrokarbureve që në shkurt të vitit 2022...

(Diskutime pa mikrofon.)

Eduard Shalsi – Ju lutem, mos e ndërprisni!

Denar Biba – Për sa i takon përqendrimit të një sërë punësh publike në pak duar, ky është një vlerësim politik, subjektiv dhe nuk hyn në konceptin e përqendrimeve në respekt të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Patjetër, nëse do të shohim gjatë punës sonë, gjatë

hetimeve tona, të cilat mund të presin edhe mbivendosen me shqetësimet tuaja, ne do të japim mendimin tonë përkatës.

Vetëm një gjobë për vitin 2021 dhe a janë vendime cilësore ...

(Diskutime nga salla)

Edhe hidrokarburet, edhe vaji vegjetal janë hetime në proces.

Për hidrokarburin ka nisur në janar, sapo nisi, prandaj shpejtësia, realisht është maksimale për t'u duartrokitur nga ana jonë, të paktën, në vlerësimin më të mirë që kemi për veten. Ndërkohë, për vajin vegjetal ishte nisur një hetim gjatë vitit 2021, ishte nën hetim paraprak dhe, në respekt të situatës, kaloi në hetim të thelluar. Në këtë moment është në stadin e hetimit të thelluar.

Do të doja të bëja një kontrapunto për një gjobë në vitin 2021. A janë këto vendime cilësore?

Unë nuk besoj se cilësia e vendimeve varet nga përfundimi i tyre. Gjoha duhet të jetë, ndoshta, edhe *last resort*. Instrumenti i fundit që AK-ja përdor, rekomandimet, marrja e angazhimeve ndërmarrjet duhet të jenë instrumentet reale. Natyrisht, gjoha është parashikuar nga legjislacioni si një instrument ndëshkues, por edhe edukues. Ne do ta japim sa herë të shohim se nuk kemi asnjë tjetër më të mirë se sa aq, në mënyrë që edhe biznesi të vazhdojë të mbetet konkurrues dhe të mos nxjerrim biznese nga tregu. Natyrisht, ato biznese, që i kanë vendosur gjobë qytetarëve shqiptarë, e meritojnë edhe gjobën nga AK-ja, por nuk besoj se është gjoha treguesi i cilësisë së vendimmarrjes së një institucioni.

U përmend hetimi ynë në lidhje me *PIR Romano Port* etj., etj., në lidhje me depozitat e gazit. Bëhet fjalë për koncesione. Çmimet ishin në respekt të marrëveshjeve të bëra me ministritë përkatëse edhe në kuadër të koncesionit. Ishin dhënë më VKM. Ne pamë përputhshmërinë e sjelljes së operatorëve koncesionarë me këto akte nënligjore dhe nuk na rezultoi se kishte abuzime me pozitën dominuese në ato raste.

Zoti Leskaj një pjesë të pyetjeve i ka që nga dëgjesa e herës tjetër. Ne i kemi mbajtur shënim ato, zoti Leskaj, kemi edhe përgjigjet për ju. Edhe po të mos ishit kujtuar ju, do t'ju kërkoja unë leje për t'ju dhënë përgjigjet përkatëse.

(Diskutime pa mikrofon.)

Në lidhje me përfshirjen e shoqërisë civile dhe të elementeve të tjera, në kuadër të shoqatave të biznesit, unë dua t'ju sjell në vëmendje se praktikisht, në ankimet e regjistruara në

AK janë edhe nga struktura të tilla, si: Qendra e Konsumatorit Shqiptar, Qendra Alert, Sindikata Kombëtare e Operatorëve Telefonikë, Bashkimi Tregtar i Shqipërisë, Shoqata e Kontabilistëve. Pra, kjo tregon që ka një vetëdije nga shoqatat e biznesit për ekzistencën, rolin dhe mundësitë që ky institucion mund t’u ofrojë atyre në gjetjen e të drejtave përmes një rruge më efikase dhe më të shpejtë, krahas me rrugën gjyqësore, në qoftë se ata do t’i kërkojnë të drejtat e tyre pranë gjyqësorit, që kërkon kohë, ndërkohë që ne jemi dukshëm më efikasë.

Unë përfitoj rasti, edhe në kuadër të advokacisë, le të shërbejë edhe dëgjesa jona, në kuadër të raportimit, për ngritjen e vetëdijes së shoqatave të biznesit, të cilat e kanë derën e hapur pranë AK-së për çdo shqetësim të tyre, qoftë edhe për t’u drejtuar me pyetje apo për të marrë informacion, sepse ne jemi gjithmonë të gatshëm t’ua ofrojmë.

A ka pasur ndonjëherë ndërhyrje të papërshtatshme nga strukturat politike apo të ngjashme ndaj AK-së?

Përgjigjja është jo.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ndryshimet në ligjin përkatës. Përse keni folur me ministren e Financave dhe kryenegociatorin...

(Ndërhyrje nga salla)

Bujar Leskaj – Mos ma deformoni pyetjen!

Denar Biba – A tregon inferioritet nga ana juaj?

(Ndërhyrje nga salla)

Eduard Shalsi – Ishte një koment.

Denar Biba – Nuk bëhet fjalë për të gjitha ndryshimet që do të sugjerojmë në kuadër të ndryshimeve të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vetëm për ndihmën shtetërore.

Duke qenë se aktualisht ndihma shtetërore është e organizuar pranë Ministrisë së Financave me një strukturë *ad hoc*, pothuajse pa asnjë lloj ndihme logjistike, prandaj edhe është kritikuar Shqipëria në progresraport pikërisht për këtë situatë. Duke qenë se kjo strukturë *ad hoc* është pranë ministrisë dhe është ngritur në kudër të progresraportit, ne folëm me këto dy subjekte, Ministrinë e Financave dhe kryenegociatorin. Patjetër që ne do të flasim me Kuvendin. Ju sjell në vëmendje që ne nuk jemi një institucion, i cili në respekt Kushtetutës, mund të sjellim legjislacion pranë Kuvendit. Pra, ai do të vijë, ose përmes lobimit të një deputeti. Fare mirë ju

apo dikush tjetër mund ta merrni iniciativën legislative, apo edhe përmes ekzekutivit. Kështu që, në këtë pikë, thjesht ne jemi duke bërë advokaci të këtyre amendimeve që po realizojmë.

A keni bërë fushatë në medie në kuadër të advokacisë?

Jo, fushatë në media nuk kemi bërë, përveçse nëse nuk kuptohet si fushatë në debatet e ndryshme në medie, të cilat ngandonjëherë edhe mund të jem përfshirë shkarazi, paçka se jam përpjekur ta ruaj jashtëzakonisht shumë veten në këtë pozitë të re të kryetarit të AK-së. Natyrisht, kjo kërkon edhe shpenzimet përkatëse dhe ne nuk i kemi të parashikuara në këtë kontekst në buxhetin tonë.

Neni 30 i ligjit, a pengon kjo njohjen, transparencën? Për ata që na dëgjojnë, bëhet fjalë për nenin 30 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili parashikon në lidhje me sekretin tregtar dhe konfidencialitetin.

Jam interesuar edhe personalisht, zoti Leskaj, me sinqeritet jua them këtë, edhe duke lexuar, por edhe duke folur me kolegë ndërkombëtarë sa herë që më është dhënë rasti, në fakt, një nen i tillë ekziston në çdo ligj përkatës antitrust, sepse këtu duhet parë dinamika e racionale që ngre legjislatori kur harton një rregullim të tillë. Në këtë rast qasja është pro ndërmarrjeve të biznesit, sepse janë pikërisht sekretet e tyre, të cilat duhen ruajtur dhe nuk duhen ekspozuar, në mënyrë që të mos dëmtohen gjatë proceseve hetimore, vendimmarrjes së agjencive të ngjashme me AK-në apo kur këto agjenci shkojnë edhe raportojnë pranë institucioneve të tilla, si Kuvendi apo parlamentet përkatëse nacionale.

Kështu që është e rëndësishme; ka edhe shumë raste gjyqësore. Më i fundit është ai midis Mikrosoftit dhe Departamentit të Shtetit të SHBA-së, ku Departamenti i Shtetit i kërkoi Mikrosoftit të dhëna dhe gjykatat thanë që: jo, nuk mund të shkoni përtej kësaj se kjo përbën sekret tregtar dhe nuk mund të ekspozohet gjithandej. Kjo është një situatë vërtetë *tricky*...

Ne po përpiqeni të bëjnë një reformulim të nenit 30, por besoj se në ata terma do të mbetet sërish, nuk do të largohemi shumë. Gjithmonë ka për të pasur një nen në një ligj për mbrojtjen e konkurrencës, i cili të sigurojë sekretin tregtar dhe konfidencialitetin.

Eduard Shalsi – Zonja Koliqi.

Emilja Koliqi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit përfaqësuesve të AK-së për përgatitjen dhe prezantimin e raportit vjetor!

Unë dua të theksoj diçka në lidhje me hetimin e thelluar që keni përfunduar gjatë vitit 2021 në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore.

Janë disa vendime, të cilat kanë përfunduar të gjitha në gjykatë dhe shumicën e këtyre kërkesë-pasive gjykata i ka rrëzuar.

Meqenëse në një pikë të tyre ka edhe penalitete, pra në vendimet tuaja keni vendosur penalitete, sa janë zbatuar këto penalitete dhe si ka evoluar zbatimi i këtyre vendimeve të nxjerra nga ana juaj?

Shpeshherë në vendimet tuaja, ju jepni edhe rekomandime për ministrinë përkatëse. Marr shkas nga hetimi i thelluar për çmimet e miellit, ku ju keni dhënë disa rekomandime për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Bujqësisë për disa akte nënligjore. Jo vetëm për këto, por edhe për raste të tjera. Si e monitoroni ju zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe si kanë reaguar këto ministri në lidhje me rekomandimet tuaja?

Diçka tjetër. Kohët e fundit keni hapur një hetim paraprak në fushën e tregtimit me shumicë të karburanteve. Shkak është bërë rritja e çmimit të karburantit, sidomos në muajin shkurt. Në fakt, detyra juaj është të mbronin interesin publik në çdo kohë dhe të bëni një monitorim të vazhdueshëm, jo vetëm atëherë kur ka një rritje galopante të çmimeve. Sepse historikisht, tregtimi me shumicë i karburanteve ka pasur një strukturë oligopoli dhe shkallë relativisht të lartë përqendrimi, si dhe është bërë shpesh objekt monitorimesh nga autoriteti juaj.

Nisur nga këto, nga një hetim i thelluar i para disa viteve, ju i keni lënë një rekomandim Ministrisë së Energjetikës në lidhje me krijimin e një njësie transparence të çmimit të hidrokarbureve, në të cilën, ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve, duhet të njoftojnë në kohë reale, brenda 15 minutave njësinë përkatëse dhe Autoritetin e Konkurrencës, në lidhje me çdo ndryshim të çmimit të shitjes me shumicë. Këtë rekomandim, ju e keni bazuar në praktikën e ndjekura nga institucione garante të konkurrencës në vendet e zhvilluara, kryesisht të Autoritetit të Konkurrencës në Gjermani. A i qëndroni përsëri këtij rekomandimi dhe a do ta kërkonin përsëri këtë rekomandim, i cili lidhet me praktika të mira?

Këto ishin pyetjet.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Mund të vijoni me përgjigjet!

Më fal! Zoti Xhelili.

Alban Xhelili – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe Autoritetit të Konkurrencës për paraqitjen që bëri.

Në vijim të fjalës së zonjës Koliqi, unë do të marr si elementë tregues gjithashtu pjesën e karburanteve, por do ta marr si shembull për të arritur te pyetja ime.

Tani ne e dimë shumë mirë se ligji “Për Autoritetin e Konkurrencës” nuk parashikon kontroll çmimesh ose vendosje çmimesh. E pranojmë edhe faktin se për çdo ngjarje kërkohet një hetim. Po marr rastin e ndryshimit të çmimeve, që ndodhi te karburantet si dhe detyrimin që na lindi për të ngritur Bordin e Transparencës, i cili faktikisht u tregoi qytetarëve se cilët janë elementët që ndikojnë në atë çmim. Gjithashtu, tregoi edhe se cili ishte marzhi që aplikohet në çmimin e shitjes.

Tani unë kam një pyetje: nisur nga ajo që ju keni parë si Autoritet i Konkurrencës, a mendoni se në të kaluarën ka pasur elementë të konkurrencës së pandershme apo të marrëveshjeve të fshehta në vendosjen e çmimit nga tregu i karburanteve? E para kjo.

Pyetja e dytë: për sa thashë më sipër, lidhur me kohën që kërkohet në hetim, a mendoni se qytetarëve u intereson penalizimi që ne u bëjmë subjekteve tregtare, të cilat cenojnë interesin publik, apo do t’u interesonte një reagim në kohë reale, më i shpejtë, me qëllim që edhe efektet negative në popullsi të ishin më të ulëta?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Mund të vijojmë me përgjigjet.

Denar Biba – Ju faleminderit!

Zonja Koliqi solli në kujtesën tonë, por dhe ngriti pyetje e shqetësime në lidhje me hetimin e zhvilluar para ca kohësh nga Autoriteti i Konkurrencës në tregun e materialeve paramjekësore dhe posaçërisht e vuri theksin te vijueshmëria e vendimmarrjes sonë në procedurat gjyqësore.

Kanë qenë shumë vendime, 14-15 vendime, pasi kanë qenë shumë operatorë të hetuar në atë periudhë, kur unë sapo kisha shkuar në Autoritetin e Konkurrencës, në pozicionin e anëtarit. Një pjesë e tyre janë gjobitur, një pjese tjetër i janë dhënë rekomandime. Në dijeninë time, vetëm dy vendime janë rrëzuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ndërkohë që këto vendime gjyqësore janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, por ende nuk ka vendime përfundimtare në lidhje me këto çështje.

Në rastin e hetimit të çështjes së famshme të tregut të importit të grurit e të miellit, po, janë dhënë rekomandime për Ministrinë e Financave, Ministrinë e Bujqësisë si dhe për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit. Nga Ministria e Financave kemi marrë përgjigje pothuajse të

menjëhershme, që këto shqetësimet tona janë edhe shqetësime të ministrisë, arsye për të cilën janë duke përgatitur një akt nënligjor në lidhje me rekomandimet tona. Nga ana tjetër, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, AKU është përgjegjës dhe ka thënë se do të nisin menjëherë hetimet përkatëse në treg.

Zoti Xhelili pyeti, nisur nga vlerësimi ynë në lidhje me hetimin në tregun e hidrokarbureve: a kemi ne ndonjë konkluzion nëse në të kaluarën ka pasur elementë të marrëveshjeve të fshehta? Ne nuk kemi ende asnjë konkluzion në lidhje me atë hetim, sepse hetimi është në proces. Kur hetimi të përfundojë, do të dalim edhe me raportin përkatës, i cili do të ketë edhe konkluzionet përkatëse. Nuk mund të them asgjë në lidhje me këtë interes, nëse do të evidentojmë marrëveshje apo abuzim me pozitën dominuese. Ata po hetohen në këtë moment.

A mendojmë ne që qytetarëve – e kjo lidhet me kohëzgjatjen e vendimmarrjes – u intereson një reagim i menjëhershëm?

Mirë do të ishte që ne të kishim reagime të menjëhershme, por i vetmi reagim i menjëhershëm, nëse mund të quhet i tillë, është nisja e hetimeve në ato raste kur ne nuk kemi pasur hetime vijuese. Përndryshe, siç e thashë, hetimet do të kërkojnë kohë, gjë që është minimumi, sepse në fund të fundit edhe ju merrni kohë në vendimmarrjet tuaja, në mënyrë që të nxirrni një produkt serioz, të arsyetuar, të bazuar në prova. Është diçka shumë e vështirë provueshmëria në kuadër të së drejtës së konkurrencës, shkeljet e ligjit të konkurrencës, evidentimi i marrëveshjeve të ndaluara, por së paku le të evidentojmë sjellje të bashkërenduar për stabilizimin e çmimeve, për çmime të padrejta, për fiksime përkatëse të çmimeve në tregun ku ne jemi duke zhvilluar hetimin. Ne i nxjerrim këto vetëm përmes analizash ekonomike.

E kemi thënë edhe kur isha këtu, madje bëri pak bujë një shembull që unë dhashë, në lidhje me faktin se si kolegët tanë italianë arrijnë deri në përgjime ambientale. Ka raste kur ata fusin persona të infiltruar. Pra, funksionojnë shumë më ndryshe, kanë kapacitete krejt të tjera, në bashkëpunim me *Guardia di Finanza* dhe autoritetet përkatëse homologe.

Ne operojmë me këto mundësi që kemi, me këto mundësi që na i nje ligji shqiptar. Si rrjedhojë, për shkak edhe të analizave ekonomike, hetimet kërkojnë njëfarë kohe. Ndoshta e humbasin interesin, por në rast se interesi ka qenë i tillë, që humbet për disa muaj, ndoshta... Gjërat që janë të rëndësishme për ekonominë në kuadër të konkurrencës nuk e humbasin asnjëherë interesin. Ka dhjetëra e dhjetëra vite, të paktën që nga *The Sherman Act* në Shtetet e

Bashkuara, pra që në vitin 1890, që në '57-ën Komuniteti European, ligje të tjera në vendet përkatëse, që kanë pasur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ta dëgjojmë pak, ju lutem, sa të mbarojë?

Mund të vijosh!

Denar Biba – Jo, unë kërkoj ndjesë nëse ju duket si leksion, ndaj e ndërpres fjalën menjëherë. Absolutisht që s'ka asnjë lloj problemi.

Eduard Shalsi – Si e ndërpret fjalën?

Denar Biba – Thjesht po thosha...

Eduard Shalsi – Po vazhdo, pra, vijojë fjalën!

Denar Biba – Po thosha se legjislacione të këtij karakteri janë historike. Madje kapitalizmi ka lindur shumë e shumë më parë, qindra vite më parë, sa që ne jemi rishtarë sa u përket marrëdhënieve kapitaliste, në këtë farë kapitalizmi që kemi prodhuar në këto tridhjetë vite, si në aspektin e demokracisë, natyrisht edhe të bashkërendësit të tij kapitalist.

Për sa vite kanë ekzistuar autoritete si yni, biznesi nuk ka reshtur ndonjëherë së bëri marrëveshje të ndaluara, sikundër për sa vite vazhdon e jeton gjyqësori në gjithë botën, krimi nuk ka reshtur ndonjëherë. Nuk ka një vendim unik në botë, i cili t'i japë fund dhe zgjidhje kriminalitetit. Nuk ka për të pasur kurrë një vendim unik të Autoritetit të Konkurrencës, të cilitdo vendi të botës, që t'i japë zgjidhje përfundimtare abuzimit me pozitën dominuese apo marrëveshjeve të fshehta.

Eduard Shalsi – Zoti Xhelili ka diçka. Në vijim kam edhe unë disa pyetje. Më pas do të kalojmë te diskutimet.

Alban Xhelili – Edhe qëllimi i pyetjes sime ishte për të kërkuar një opinion nga Autoriteti i Konkurrencës. Ajo që unë dija, por që u shfaq edhe këtu, është se aktualisht ligji që rregullon Autoritetin e Konkurrencës ka goxha mangësi për të pasqyruar ose për të pasur reagime të rëndësishme në treg.

Zoti Biba përmendi edhe rastin e Italisë, që shkon edhe më tej, që shkon edhe te kontrolli i çmimit. Që nesër ta thërrasim prapë këtu Autoritetin e Konkurrencës dhe t'i themi se cili është reagimi juaj dhe cili është efekti te qytetarët, patjetër që nismëtarët e ndryshimit ligjor duhet të kenë parasysh dhe duhet të marrin në konsideratë edhe këto elemente, pra të marrin në konsideratë ngjarjet e fundit që kanë ndodhur këtu, që kërkojnë patjetër disa kompetenca më të

thelluara. Më pas ato shoqërohen edhe me elementë të tjerë, me buxhet më të lartë e të tjera. Pra, ky ishte qëllimi i pyetjes sime. Me sa kuptova unë, nëse s'e kam kuptuar gabim, edhe vetë Autoriteti i Konkurrencës ka ca elementë që e pengojnë, duke e detyruar pastaj të shkojë në hetime afatgjata.

Është vetëm një pikë, me të cilën nuk isha dakord, ku u tha se hetimi kërkon kohë dhe nëse çështja do të kish qenë me interes, nuk do ta humbte interesin, pavarësisht kohës. Çështja nuk e humb interesin edhe po të jetë banale, sepse ka njerëz që mund të duan ta bëjnë të rëndësishme dhe të përfitojnë, por efekti te qytetarët e humb rëndësinë. Kjo ngaqë efektet negative financiare, ata i kanë pësuar dhe nuk i rregullojnë dot më, pavarësisht se si shkon historia e çështjes.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Të nderuar anëtarë, kam disa pyetje. Para se të bëj pyetjet, do të doja të sillja në vëmendje faktin se ishte i tepërt sugjerimi juaj në lidhje me të qenit të kompleksuar të deputetëve sa i takon rrogës. Është tjetër gjë të diskutojmë nivelin e pagave, është tjetër gjë të paragjykojmë llojet e debateve. Gjithsesi, çështja e pagave në institucionet e pavarura ka qenë edhe një shqetësim imi i kahershëm, që u duk sikur u zgjidh në një institucion, por në fakt *on block*, një debat i gjerë, i thellë, në të gjitha institucionet e pavarura nuk është bërë, ndaj sa më shpejt të bëhej, aq më mirë do të ishte. Jo se kjo do të jepte një zgjidhje përfundimtare, por së paku do të vinte në ekuilibër mënyrat e pagesës, aq më tepër në një treg ku dinamika po dikton disa sfida shumë të rëndësishme.

Dua të pyes në lidhje me azhurnimin e institucionit me atë çfarë ndodh me autoritetet homologe në botë. Keni një departament, keni një njësi kërkimi. Është shumë e rëndësishme të kuptojmë çfarë sfidash po kalojnë sot vendet, dhe si u përgjigjen këtyre vendeve autoritetet e konkurrencës.

E dyta, kur nga një personalitet në fushën e konkurrencës, me një aktivitet mbi gjysmë shekulli, dëgjova që tha tekstualisht: “Objektivi i këtij autoriteti nuk është konkurrenca, por objektivi është eficienta e tregut. Konkurrenca është procesi”, kjo është diçka që ndryshon qasjen në lidhje me aktivitetin. Sa është i azhurnuar institucioni juaj me rolin e aktivitetit dhe me rolin e autoriteteve të konkurrencës në botë? Cilat janë marrëdhëniet tuaja direkte me këto autoritete? Si i shkëmbeni eksperiencat dhe si konsultoheni?

Unë personalisht, në këtë komision, u vura në një pozitë të vështirë nga kërkesa e dy deputetëve, që në dëgjuesën e kërkuar nga zonja Tabaku, në lidhje me çmimet e miellit, të kishim procesverbalet e vendimmarrjeve. E jo vetëm procesverbalet e vendimmarrjeve, por edhe dokumentet e hetimit. Nga njëra anë kisha kërkesën legjitime të deputetëve, një prej të cilëve jam edhe unë, ndërsa nga ana tjetër kisha edhe ligjin, i cili thotë: “Autoriteti mund t’u japë informacion vetëm organeve gjyqësore.”.

Në këtë mëdyshje iu referova dy vendeve dhe dy komisioneve homologe, të cilat e kishin pasur një debat të tillë, por që e kishin zgjidhur ashtu sikundër e zgjidhëm edhe ne. Duke qenë se pjesë të vendimmarrjeve kanë elementë të sekretit tregtar, atëherë, ato që kishin bërë këto parlamente ishin një përmbledhje e procesverbaleve, duke larguar ato pjesët e ujërave, po themi, apo debatet shterpe, që nuk ka interesojnë.

Pra, e solla këtë shembull për të thënë se i dhamë zgjidhje një kërkesë, duke gjetur një ekuilibër dhe duke ruajtur të drejtën legjitime të deputetëve, por duke ruajtur edhe Autoritetin nga mbrojtja e sekretit tregtar. Prandaj pyeta: në ç’ marrëdhënie jeni? Madje, nuk e fsheh që edhe ne, si parlament, do të kërkojmë të sjellim në Shqipëri, sigurisht duke e rakorduar edhe bashkërisht, figura të shquara apo personalitete të shquara në fushën e Autoritetit të Konkurrencës, për të kuptuar akoma më mirë në gjithë atë tallava debatesh, shpeshherë edhe nëpër studiot televizive, më shumë çorientuese se orientuese, thelbin e Autoritetit dhe funksionet e tij.

Pyetja tjetër: në proceset hetimore, ju keni shumë kontakte me institucione të tjera: ministri, agjenci, drejtori; gjatë punës tuaj, konstatooni se ka marrje informacioni të vonuar apo jo cilësor? Sa ndikon ky informacion në shpejtimin e punës? Sepse u kërkuar që hetimet të përshpejtohen, dhe të gjithë do të donim që hetimet të ishin sa më cilësore dhe të kryeshin brenda një kohe sa më të shkurtër. Cilët janë faktorët jashtë institucionit, që do ta ndihmonin këtë proces? Gjatë kësaj kohe, bie fjala sot, kur lajtmotivi është teknologjia e informacionit apo revolucioni dixhital, që po sjell transparencë, eficiencë në shumë e shumë transaksione, a e ka parë autoriteti dhe a e ka funksion që, teksa heton, të rekomandojë në lidhje me disa lloj procesesh që duhen përmirësuar nëpër institucionet e tjera?

E treta, ju përmendët faktin se është e nevojshme të rritet numri i punonjësve. Pyetja ime është: sa efikas dhe eficient është institucioni? Sepse numri është një element, ndërkohë që janë shumë komponentë të tjerë, të cilët mund ta bëjnë një institucion më efikas e më eficient. Mund

të punosh me dhjetë vetë në mënyrë shumë më efikase e eficiente se sa me tridhjetë e gjashtë, me dyzet e gjashtë, me gjashtëdhjetë vetë.

Teksa po diskutoni mbi ligjin, a keni menduar të bëni një rishikim të organogramës, një rivlerësim të të gjithë punonjësve, një rivlerësim të funksioneve? Nuk e di ku jeni me procesin e digjitalizimit brenda institucionit. Për mua ka qenë e papranueshme që protokollet të jenë ende me shkrim dore dhe me ato regjistrat e lodhur, ndërkohë që digjitalizimi i proceseve brenda institucioneve do të ndihmonte shumë për të kuptuar akoma më mirë nevojat për punonjësit. Ne po flasim për sisteme, por po flasim edhe për njerëz. Konstatohet dukshëm në raportin që keni sjellë që është larguar edhe një IT dhe në kohën kur ka me qindra kompani në teknologjinë e informacionit të regjistruara vetëm vitin e fundit, konkurrenca në tregun e teknologjisë së informacionit në Shqipëri do të jetë shumë më e ashpër, çka do të thotë që numri dhe rritja është një element që duhet gjykuar. A po mendoni edhe elementin tjetër për ristrukturimin e institucionit?

Në fakt, është hera e dytë që ju kemi në komision dhe ne, si komision kemi vendosur që raportet me institucionet e pavarura *officialy* dhe *unofficialy* t'i kemi shumë me të shpeshta, por do të kërkoja prej jush, e përmendi dhe Blerina, edhe një *neps letter* mujore, sepse është shumë e rëndësishme edhe për ne si deputetë, që kemi ende nevojë të mësojmë, unë i pari, pasi jam shumë i hapur karshi çdo lloj dëgjese apo informacioni që do të na zgjeronte njohuritë për të kuptuar më mirë rolin dhe raportin që kemi në këtë proces të rëndësishëm.

Unë nuk dua të besoj se sot Autoriteti i Konkurrencës do të zgjidhë të gjitha problemet ekonomike të Shqipërisë, por, nga ana tjetër, duhet të kuptojmë se cilët janë sektorët, e përmendi zonja Tabaku me shumë të drejtë. Për hir të së vërtetës, bien në sy aty dy hetime, një me *placations* dhe me një tjetër. A e kemi luksin të marrim dhe të hetojmë një ose dy ndërkohë që ka probleme madhore? Pra, teksa caktohen prioritetet, ndoshta të dyja këto janë iniciuar nga një *e-mail* apo një kërkesë, sepse nuk dua të besoj se janë iniciuar me telefon, a merrni në konsideratë problemet me shqetësuese të qytetarëve?

Synimi ynë është mbrojtja e konsumatorit apo, e thënë më mirë, mirëqenia e konsumatorit. Nuk mendoj se do t'i ezaurojmë të gjitha pyetjet me këtë raport vjetor, e thashë që kemi nisur një komunikim dhe besoj se komunikimi si asnjëherë më parë do të na sjellë të dyja institucionet nga pozitat e tyre në disa zgjedhje që do ta përmirësojnë punën akoma më shumë.

E fundit, që një institucion të performojë si duhet të ketë mjedise pune të përshtatshme, sisteme, sisteme rekrutimi, sisteme menaxhimi dhe logjistikë të mjaftueshme. Na ndodh rëndon në nëntor kur diskutojmë për buxhetin, që na vijnë kërkesat në moment të fundit, ndaj duam t'i inkurajojmë institucionet e pavarura që tani të konfigurujnë dhe të argumentojnë kërkesat e tyre, por jo duke u nisur nga ideja që kemi 46 ta bëjmë 52, por nga një analizë, nga një *due diligence* shumë më e thellë e institucionit.

Përgjigjuni, pastaj kush ta dojë fjalën për diskutime...zoti Braçe, zonja Tabaku, zoti Leskaj apo zonja Gjylameti.

(Diskutime pa mikrofon.)

Thjesht për saktësim e thashë. Kjo vlen se ma kanë thënë edhe deputetë të tjerë edhe për ju apo vetëm për atë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Për të gjithë ne.

Eduard Shalsi - Nuk vlen?!

Për të gjithë? Mirë zgjidheni me zotin Leskaj. Mund t'u përgjigjeni pyetjeve.

Urdhëroni, fjala është për ju.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Biba mund të vijoni me përgjigjet.

Denar Biba – Zoti Shalsi, ju u interesuat nëse Autoriteti i Konkurrencës është përditësuar me sa ndodh sot në botë dhe nëse ne kemi një strukturë të posaçme, e cila lexon, mëson dhe prodhon analiza, raporte, për autoritetin. Ne jemi të përditësuar përgjithësisht, të paktën nga bisedat që zhvillojmë me kolegët, që janë të një cilësie vërtetë të lartë profesionale, më duhet të shpreh vlerësimin më të lartë për kolegët, e ndiejmë të gjithë veten shumë mirë në prani të njëri-tjetrit nga aspekti profesional, por në përgjigje reale, konkrete të pyetjes suaj, ky përditësim lidhet kryesisht me përgjegjësinë personale të secilit nga ne se sa është produkt i një strukture të posaçme që ka institucioni. Në këtë pike po i jap një përgjigje edhe pyetjes suaj në lidhje me rishikimin e mundshëm të organigramës dhe të elementëve të tjerë. Autoriteti ka pasur më përpara një sektor të tillë, i cili është shkrire tashmë, nuk e di pse u vlerësuar në atë kohë i panevojshëm, se nuk di si ta etiketoj ndryshe, por besoj se do të rikthehet një strukturë e re në kuadër të riorganizimit, të cilin ne, si komision, kemi vlerësuar të ndodhë pas rishikimit të ligjit, duke qenë se disa elemente të ligjit me patjetër do të duhet të reflektohen edhe në organizimin e

ardhshëm të institucionit. Personalisht unë kam 3 muaj në drejtim të institucionit, ndaj nuk do të ishte as e mençur e aq më pak profesionale të nxitohesha me kërkesën për një riorganizim, kështu që do t'i jap pak kohë vetes. Edhe një nga anëtarët në komision është e re, ne presim prurje të tjera në komision në kuadër të shqetësimit që ngritëm për boshllëkun në organikën e komisionit.

Pas miratimit të ligjit, duke parë nga këndvështrimi nëse do të na miratohet ndihma shtetërore si pjesë organike tashmë e punës sonë, me patjetër do të kërkojmë ndryshim në organigramë. Pas përfundimit të ligjit do të jemi këtu të gjithë bashkë, duke shpresuar që ta miratoni. Unë e thashë që në fillim që ne, jo vetëm ne, por çdo institucion i pavarur, i krijuar nga Kuvendi, në logjikën kushtetuese nuk është gjë tjetër veçse një zgjatim instrumental i Kuvendit. Kuvendi përmes legjislacionit shpik institucione të tilla, të cilat profesionalizohen, pavarësohen, por në thelb mbeten zgjatime të misionit që ka Kuvendi i Republikës.

Për sa i përket marrëdhënieve tona me homologët ndërkombëtarë, ne jemi anëtarë të Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal RCC dhe jemi anëtarë të rrjetit ndërkombëtar të konkurrencës ICN, marrim pjesë në kongreset, trajnimet, në *workshop*-et vijuese që ata bëjnë disa herë në vit. Në kuadër të Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal kemi ngritur një rrjet të shkëmbimit të informacionit, i cili është efikas, jo gjithmonë kolegët përgjigjen, ne mundohemi të përgjigjemi sa herë ata ngrenë pyetje, pra është një marrëdhënie digjitale, meqë ju jeni ta apasionuar pas konceptit, gjithsecili shtron pyetje për interesat e ditës për çështjet nën hetim dhe kolegët ndërkombëtarë japin eksperiencat e tyre legjislative, ose nga këndvështrimi i precedentëve përkatës që kanë. Po ju them që është realisht efikase dhe ndonjëherë është realisht ndriçuese, jo gjithmonë përgjigjen, ose të kenë gjithmonë të njëjtat shqetësime me ne, por përgjithësisht ky rrjet funksionon.

Në lidhje me marrëdhëniet me institucionet dhe autoritetet e tjera publike në vend në kuadër të informacionit, natyrisht në kuadër të hetimeve tona ne kërkojmë informacion nga autoritetet dhe institucionet publike, ndonjëherë kemi pasur vonesa në kthimin e ndonjë përgjigjeje, logjikshëm që kjo ndikon në zgjatjen e hetimit, ndonjëherë detyrohemi t'ua ripërsëritim kërkesat tona, ka raste që përgjigjet nuk vijnë posaçërisht të elaboruara dhe sërish detyrohemi t'ua përsërisim kërkesat. Vura re me shumë interes një sugjerim tuajin që në kuadër të hetimeve që bëjmë, dhe ka nisur ky proces, me këtë rast mund t'i jap përgjigje edhe shqetësimit të zonjës Tabaku absolutisht të drejt në lidhje me koncesionet, PPP-të, të cilat mirë

ose keq, nuk janë paraparë nga AK-ja, në kuadër të hetimeve që bëjmë, një praktikë kjo e vendosur tashmë në autoritet, të evidentojmë se problematika nuk lind posaçërisht nga sjellja e operatorëve, por sa është sjellje e operatorëve aq është dhe produkt i koncesionit apo i kuadrit legjislativ, që ka rregulluar atë situatë, në do ta sjellim në vëmendje të publikut dhe të Kuvendit të Republikës këtë gjë.

Pyetja tjetër ka të bëjë me logjistikën, mjediset dhe teknologjia. Unë e thashë edhe herën e kaluar, ky institucion kur është krijuar në vitin 2004 ka pasur 16 punonjës dhe sot që ka 46 është në po të njëjtat ambiente kur u krijua për herë të parë.

Sot që flasim jemi në epokën digjitale, flasim për hetime që ne duhet t'i bëjmë në platformat digjitale apo në tregjet digjitale, të cilat kërkojnë kompjuterë jashtëzakonisht të sofistikuar, nuk e di se sa e dini, por patjetër që e dini, ne vuajmë për kompjuterë fare të zakonshëm, *personal computers* për të hartuar raporte fare të zakonshme në *word*, e jo më për të pasur algoritme dhe për ngritur teori të tjera matematikore përmes matematikanëve, inxhinierëve të teknologjisë së lartë, që do të duhet t'i kishim në stafin tonë. Këto janë problematikat dhe ne nuk mund të rekrutojmë staf të këtij karakteri, sepse me këto paga nuk besoj se do të na vinte kush.

Ju faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjalën e kanë zoti Leskaj, zoti Braçe, zonja Tabaku dhe e mbyll zonja Gjylameti.

Zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Në fakt, unë po e nis nga ajo që më kujtoj kryetari. Kur zhvilluam seancën e mëparshme ne i bëmë këto pyetje dhe e zhvilluam diskutimin në një frymë shumë konstruktive dhe unë e theksova. Ideja është që edhe ju frymës konstruktive duhet t'i përgjigjeni me të njëjtën frymë. Mendoj se institucioni juaj ka nevojë edhe për llogaridhënie, edhe për transparencë, si të gjitha institucionet e tjera.

Qëllimi i pyetjes sime të parë apo të katërt ishte për veprimtarinë e vitit 2021 dhe për raportin, të cilin e keni përgatitur mirë, por duhet t'u kushtonit edhe një rëndësi të veçantë marrëdhënieve tuaja dhe raportit, komunikimit dhe punës që ju keni pasur me komunitetin e biznesit të konsumatorit dhe me organizatat e fushës të shoqërisë civile.

Në raportin tuaj, i cili, po e them, është i mirë, është raport performance, keni vendosur vetëm 3 paragrafë për sa u përket këtyre raporteve, që i keni futur në pjesën 4/2. Janë 3

paragrafë, as gjysmë faqeje, “Advokatia e konkurrencës”. Në këtë drejtim ju duhet të punoni më tepër dhe duhet të jeni më të motivuar, se unë shikoj një indiferencë për sa i përket transparencës dhe llogaridhënies.

Vështirësitë e jashtëzakonshme që u shkaktuan dhe po vazhdojnë në treg nga rritja e paprecedentë e çmimeve jetike për popullatën, sikurse ishin çmimet e mallrave kryesore ushqimore, të energjisë elektrike për biznesin, çmimet e karburanteve e të tjera kërkonin një vëmendje maksimale dhe punë të thelluar të Autoritetit të Konkurrencës. Për mendimin tim, ju duhet ta kishit analizuar me përgjegjësi, me shpejtësi të vërtetë dhe në detaje nivelin e lartë të pasigurisë për të nesërmen dhe mundësinë e abuzimit të operatorëve në treg. Në këtë situatë, për mendimin tim, Autoriteti i Konkurrencës u shfaq larg pritshmërive të qytetarëve. Ju mund të kishit zgjedhur praktikën e njoftimeve publike dhe të paralajmërimeve publike ndaj operatorëve në treg, në raste të tilla të jashtëzakonshme, të cilat janë ndjekur dhe nga struktura të tjera përëndimore, të cilave ju referuat në diskutimet tuaja, në përgjigjet ndaj pyetjeve tona, por, në fakt, ju nuk e zgjodhët një qasje të tillë dhe nuk arritët të plotësonit pritshmëritë e qytetarëve dhe të garantoni ndërveprimin e barabartë ndërmjet operatorëve të biznesit në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të ushqimeve të shportës, karburanteve, energjisë elektrike e të tjera.

Së dyti, ju duhet ta shikoni me shumë përgjegjshmëri dhe ta luftoni këtë tendencë që po vërehet, të një largimi nga partneriteti real juaj me biznesin. Ju duhet të jeni mbrojtës të konkurrencës, mbrojtës të të gjitha bizneseve, jo vetëm të një grupi.

Së treti, domosdoshmëria për një analizë të vazhdueshme dhe të thelluar.

Për mendimin tim, Autoriteti i Konkurrencës duhet t’i analizojë me më përgjegjësi dhe me thellësi arsyet se përse disa raste, disa hetime tuajat kanë dështuar, hetime këto disavjeçare, se përse keni këtë shpejtësi të ulët nga fillimi.

Po ju jap një shembull, që e kam nxjerrë nga raporti juaj. Për tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe bujqësore me vendimin nr.783, datë 12.3.2021 ju hapët procedurat e hetimit. Me vendimin nr.806, datë 4.6.2021, u vendos përsëri nga Komisioni i Konkurrencës hapja e procedurave të hetimit, pra pasi u bënë hetimet nga specialistët tuaj. Ju thoni që raporti i hetimit ka kaluar për shqyrtim pranë Komisionit të Konkurrencës. Po ta shikoni, harku kohor është një vit. Në rast se ky raport hetimi do të kishte një vendim tuajin si

komision konkurrence, mendoj se dhe situata e tanishme do të ishte shumë më ndryshe. Këto firma do të reflektonin.

Së katërti, dua të përsëris vërejtjen miqësore që bëra për kolegen time. Ju nuk duhet të dekurajoheni nga vendimet e gjykatave. Ju duhet ta vazhdoni punën tuaj profesionale, të jeni të qetë në ndërgjegjen tuaj në shërbim të qytetarit dhe të biznesit.

Për sa i përket kërkesës për interpretim që ju bëra, qëllimi im ishte të shikoja se si e keni ju filozofinë në raport me qëllimin e mirë që ju deklaroni me fjalë për bashkëpunim me Kuvendin apo si zgjatim i Kuvendit. Në fakt, këto janë institucione të pavarura, që i shërbejnë Kuvendit në misionin e tij mbikëqyrës dhe nuk mund të keni konceptin shumë refraktar për sa i përket një shtojce në nenin 30.

Megjithatë, unë, si deputet, i njoftoj kolegët e mi se këto ditë do të paraqes një kërkesë për ndryshim në ligjin nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Po ju lexoj nenin 30: “Anëtarët e Komisionit të Konkurrencës dhe të gjithë punonjësit e sekretariatit...ruajnë sekretin profesional dhe nuk i japin të dhëna konfidenciale, të siguruar gjatë kryerjes së detyrave të tyre, asnjë personi ose institucioni, me përjashtim të rasteve kur duhet të dëshmojnë përpara gjykatës”. Shtojca ime është: “... ose kur të dhënat konfidenciale dhe të sekretit tregtar kërkohen nga një anëtar, nga një grup anëtarësh të Kuvendit apo nga komisione të tij sa herë e kërkon detyra, misioni dhe nevojat për informim të Kuvendit, anëtarëve dhe strukturave të tij”. Kjo është kërkesa që do të bëj unë. I ftoj edhe kolegët të më mbështesin, që të mos ndodhemi përballë rasteve kur edhe Autoriteti të na vendosë bllokadë. Forma e përcjelljes së informacionit, me kërkesat tuaja, për ruajtjen e sekretit tregtar mund të gjendet me mirëkuptim, ashtu siç e zgjidhi pjesërisht situatën kryetari, që e tha në seancën e mëparshme që zhvilluam.

Së fundi, dua t’ju përsëris një thënie të Mithat Frashërit, që jua kam thënë: “Në punë kije për nder e lavdi të jesh shërbestar”. Edhe ju duhet ta keni për nder e lavdi të jeni shërbestar për mbrojtjen e konkurrencës, por duke mbrojtur interesat e biznesit dhe të qytetarëve, pavarësisht parimeve klasike. Ju tani mund të flisni edhe një orë për parimet e konkurrencës apo të ligjit. Ju dhe çdo institucion tjetër, për mendimin tim, duhet të kërkonin që të gjitha kërkesat e ligjit, ekzigjencat që ju keni ndaj institucioneve që kontrollojnë, auditoni, verifikoni e vlerësoni, të shkojnë në dobi të interesave të qytetarëve shqiptarë. Në rast se është dëshira e mirë, në rast se është kjo filozofi: “Në punë kije për nder e lavdi të jesh shërbestar”, besoj se kjo arrihet,

kuptohet, pa cenuar në asnjë rast ligjin në fjalë, ligjin tuaj organik, Kushtetutën, duke ecur gjithmonë në vijat e bardha të ligjit të Kushtetutës, që garantojnë punën e mirë të institucionit.

Ju faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Leskaj!

Po, zoti Braçe.

Erion Braçe – Në fakt, Mithati duhet të ishte shërbëstar në luftë, Bujar, por zgjedhi keq.

(Zoti Bujar Leskaj flet pa mikrofon)

Po, Bujar, po!

(Zoti Bujar Leskaj flet pa mikrofon)

Jo si ballist, Bujar.

(Zoti Bujar Leskaj flet pa mikrofon)

Sikur nuk shkon morali në luftë, Bujar.

(Zoti Bujar Leskaj flet pa mikrofon)

Po pra, ke shumë të drejtë!

(Zoti Bujar Leskaj flet pa mikrofon)

Kjo është tjetër gjë, Bujar.

(Zoti Bujar Leskaj flet pa mikrofon)

A do të më lësh ta mbaroj?

(Zoti Bujar Leskaj flet pa mikrofon)

Dakord.

Natyrisht që ndodhemi në mes të një krize çmimesh. Inflacioni për muajin mars shkoi 5,7% dhe njoftimet janë që mund të shkojë edhe më sipër. Afërmendsh që Autoriteti i Konkurrencës nuk cakton çmime; nuk e ka as në detyrën dhe as në funksionin e tij të caktojë çmime drejtpërdrejt. Ama, është ekonomia, është tregu dhe kërkesë-oferta, që praktikisht duhet të vendosin çmimet në treg.

Në mes të kësaj situatë, qeveria ka zgjedhur një instrument të sforcuar forcuar, por për të mbrojtur konsumatorin, për të mbrojtur qytetarin, që është krijimi i këtyre bordeve, njëri prej çmimit e naftës dhe nënprodukteve të saj dhe tjetri për mallrat kryesore ushqimore, kryesisht për produkte të fabrikuara.

Natyrisht që funksionimi i bordeve ka nxjerr në pah faktin që, përveç inflacionit të importuar, ne po paguajmë edhe koston e abuzimit apo të mosfunksionimit të tregjeve, të paktën

në këta dy sektorë kaq të rëndësishëm. Mosfunksionimi i tregjeve dhe mungesa e konkurrencës në to natyrisht që është një problem shumë i madh, që praktikisht po e paguan qytetari sot në treg, pavarësisht ndërhyrjes së qeverisë me anë të dy bordeve.

Puna që po bëjnë këto dy borde po verifikon gjithmonë e më tepër se edhe në vitet e mëparshme mosfunksionimi i tregjeve ka sjellë kosto për qytetarin. Marrëveshjet për norma të larta fitimi natyrisht që kanë qenë një barrë e rëndë për qytetarët. Këtu praktikisht kanë përgjegjësi të gjithë. Kjo lidhet me strukturën e ekonomisë që kemi ndërtuar dhe, pa diskutim, edhe me mbikëqyrjen e tregjeve, sipas detyrave respektive që secili institucion ka pasur dhe duhet të ushtronte.

Praktikisht bordi po nxjerr në pah se, fjala bie, në tregun e grurit kemi vetëm 4 operatorë, që zotërojnë gati 98% të tregut; në tregun e miellit po kaq; në tregun e vajit janë 4 operatorë, që zotërojnë gati 92-93% të tregut; në tregun e sheqerit 3 operatorë zotërojnë gati 96% të tregut; në tregun e orizit 3 operatorë zotërojnë deri 90% të tregut. Është një problem shumë i madh konkurrenca e ngushtuar në kaq pak duar, përqendrimi i tregut në të tilla përmasa dhe, natyrisht, kostot që vijnë pikërisht prej këtyre përqendrimeve. Për të mos folur pastaj për reagimin e njëkohshëm në vendosjen e çmimeve, në fiksimin e tyre nga një konkurrencë fare banale, që lëviz me 1-2 lekë për kilogram, thjesht dhe vetëm për t'u hedhur hi syve të gjitha institucioneve, që, më në fund, tani, me këtë krizë të çmimeve dhe me këtë normë kaq të lartë inflacioni, më e larta e dekadës, janë hapur për të parë se çfarë nuk funksionon në treg dhe sa i madh është abuzimi në kurriz të qytetarëve.

Pa diskutim që kjo mungesë konkurrence në treg dhe ky nivel i lartë përqendrimi është edhe në tregjet e lëndëve të para, që pastaj ndikojnë drejtpërdrejt dhe në koston e prodhimit. Nafta, për shembull, që është kthyer në një produkt ndër më të lakuarit kohët e fundit, ka jo vetëm përqendrim, por edhe mungesë të plotë transparence. Pavarësisht funksionimit të bordit, mungesa e transparencës është themelore. Dikush fsheh diçka dhe askush nuk merr përsipër ta zbardhë nga fillimi deri në fund. Është shumë e rëndësishme për të kuptuar se si blihet nafta nga kompanitë e shumicës, se si furnizohen kompanitë e shumicës, se si kompanitë e shumicës pastaj furnizojnë kompanitë e pakicës, që në disa raste janë po të njëjtat, për të mos thënë që janë themeloret e, natyrisht, ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e çmimeve.

Për të thënë të drejtën, bordi (ne do ta kemi dhe një diskutim kur të vijë akti normativ për formulën e përcaktimit të çmimit të naftës dhe nënprodukteve të saj, gjithashtu, edhe të gazit)

ende nuk po e bën të qartë të gjithë transaksionin, nga blerja në bursë e deri në shitjen në stacionet e pompimit të naftës apo të benzinës dhe të gazit në të gjithë territorin e vendit. Natyrisht që në bursë nuk blihet sot për nesër. Në bursë blihet për një muaj, për dy muaj, për tre muaj deri në gjashtë muaj. Po t'jua hap tani, mund të shihni se ka çmime komplet të ndryshme. Në qoftë se unë dua të blej sot për në dhjetor, çmimi për naftën e papërpunuar në bursë kuotohet apo referohet diku te 88-89 dollarë për fuqi. Puna është që në dhjetor, skema që na është referuar jo nga bordi, por nga kompanitë, thonë që duhet të shesin me çmimin korrent të bursës në atë periudhë. Praktikisht, shitja me shumicë thuajse është përqendruar në një apo dy, që kompanitë e naftës na i referojnë si *broker*-a, që blejnë në bursë, depozitojnë në depozitat e këtyre kompanive dhe shesin ditën që dalin nga depozitat në autobot me çmimin e bursës. Natyrisht që është një skemë e transferimit të riskut, por që ka përqendruar tregun, që e ka zbehur konkurrencën në të dhe ka sjellë për pasojë këto çmime që ne kemi sot, që do t'i kemi dhe nesër e në vijim, se gjithçka që ndodhi në harkun e 2-3 ditëve, kur çmimi shkoi 260 lekë për litër, në mënyrë abuzive, duke zëruar totalisht edhe çmimet në pikat e bardha e jo më ato të brenduara, pra duke i bërë njësoj, pa diskutim që është një abuzim i pastër në treg, reflekton shkallën e lartë të integritimit dhe, pa diskutim, edhe të përqendrimit.

Për tregun e plehrave kimike tashmë ka edhe një vendim të atakuar në gjykatë, i cili nuk më emocionon fare. Për sa kohë që kanë mbështetje politike, edhe në gjykatë, edhe ku të doni ju do të shkojnë ata, e për sa kohë që qeveria, pavarësisht se e thotë me gojë, nuk merr asnjë masë për të bërë verifikimet nëpërmjet bordit edhe të këtyre çmimeve tani, pa diskutim që kështu do të ndodhë, në gjykatë do të shkojnë. Madje, nuk është asnjë habi që, me gjykatat që kemi ne, të marrin edhe atë që nuk e kanë marrë deri sot, të drejtën, pavarësisht se e kanë humbur në disa shkallë gjykatash më herët. Abuzimi në to është skandaloz.

Po ju referoj vetëm të dhënat për një kompani. Bëhet fjalë nga korriku i vitit që shkoi e deri tani. Në muajin korrik të vitit që shkoi marzhet e fitimit apo diferencat kanë qenë fare minimale: 7,9%, 13% dhe vetëm për dapiin shkonte në 17%. Në korrikun e vitit të kaluar marzhet e fitimit apo diferencat kanë qenë minimale 7,9%, 10 dhe vetëm për dapiin shkon 17%. Në gusht ka filluar luhatja, sepse bëheshin gati për plehërimin bazë bujqit për mbjelljet e vjeshtës, dapi shkon në diferencë gati 26%. Në shtator përsëri po në këto trende. Në tetor nitrati shkon në 30% diferencë, dapi shkon në 39% diferencë dhe ureja në 25% diferencë. Në nëntor nitrati shkon në 41% diferencë, ureja në 34%, dapi shkon në 43% diferencë. Në dhjetor, ku bëhemi gati për të

blerë për pranverën, dapi shkon në 52% diferencë, pavarësisht se e kanë blerë me 47 lekë për kilogram, shkon në 98,2 lekë kilogramë në shitje. Ureja ruan një trend normal, sepse nuk plehërohet në atë kohë, ndërkohë që nitrati nga 38 lekë shkon në 76 lekë për kilogram, 50% diferencë. Pastaj janari e shkurti i këtij viti janë nam, ku pavarësisht se e kanë blerë nitratin me 38 lekë, e kanë shitur 85 lekë, 56% më shumë. Pavarësisht se dapin e kanë blerë me 47 lekë, e kanë shitur 104 lekë, 55% më shumë. E njëjta histori edhe në shkurt, për marsin nuk flas, sepse është ndikimi, siç thonë ata, i luftës, pavarësisht se nuk kanë importuar asnjë gram prej 28 shkurtit, kur filloi lufta e deri në mes të muajit mars, pavarësisht se norma ka shkuar 62%. Pra, tatimet që po merren me këtë histori, në funksion edhe të bordeve, kanë evidentuar faktin që tregjet janë të përqendruara dhe nuk funksionon në to konkurrenca fare. Pikërisht për këto arsye çmimet e lëndëve të para në bujqësi kanë shkuar në të tillë parametra. Çfarë dua të them me këtë? Dua të them se ne e kemi të gjithë mundësinë që t'u kursejmë qytetarëve kostot e inflacionit, që vijnë pikërisht nga abuzimi. Pra, të shmangim abuzimin nga çmimet që kanë edhe për lëndët e para, edhe për ushqimet. Është detyrë, pa diskutim, e agjencive ligjzbatuese fiskale, ashtu siç do të duhej që reformat të kishin dhënë rezultat pikërisht duke mbrojtur konsumatorin. Fiskalizimi duhej të kishte mbërritur në të gjithë këtë sektor për të cilin po flas, sidomos tek tregu i plehrave kimike dhe, natyrisht, gjithsekush të kuptonte sa është çmimi, sa është kostoja që na vjen nga importi dhe sa është abuzimi këtu brenda.

E ngre këtë shqetësim, sepse bordet janë të përkohshme. Ajo që duhet të jetë e përhershme, është liria dhe konkurrenca në tregje. Është shumë e rëndësishme që çmimet të mos caktohen më, siç po caktohen sot, sepse, pavarësisht se bordet po tentojnë të mbrojnë konsumatorin, të mbrojnë qytetarin që drejtohet në treg për të blerë, praktikisht po ndiqen nga operatorët, nga sipërmarrjet, nga biznesi me çmime të unifikuara. Sot edhe pikat e bardha e shesin me të njëjtin çmim si pikat e brenduara në treguan e hidrokarbureve, ndërkohë që gjithë jetën kanë qenë ose 10 deri në 15 lekë më poshtë sesa pikat e brenduara. Kanë unifikuar çmimin dhe konkurrencë nuk ka më. E njëjta histori është edhe te produktet ushqimore aty ku ka kontroll, se atje ku nuk ka kontroll vazhdon të abuzohet me të njëjtën masë, siç abuzohej edhe më përpara, por atje ku ka kontroll çmimet janë unifikuar dhe konkurrenca është zbehur, thuajse nuk ekziston. Prandaj, është shumë e rëndësishme që Komisioni i Konkurrencës të bashkëpunojë me të dyja agjencitë ligjzbatuese, edhe me tatimet, edhe me doganat, me qëllim që të informohet në kohë për çfarë ndodh me çmimet në import dhe çfarë ndodh edhe me çmimet që reflektojnë

edhe për qëndrimin e tregut, por edhe marrëveshjet në treg të ndaluara gjithmonë dhe që kanë kosto mbi qytetarin.

E dyta, duhet të përgatitemi pikërisht për atë që thashë, për momentin që bordet humbin rolin e tyre në treg. Janë të përkohshëm, aktet normative, natyrisht, të referojnë që bordet të jenë të përkohshme dhe për të rikthyer konkurrencën në treg duhet të mendojnë tashmë të gjitha autoritetet e tjera, përfshi edhe institucionin për të cilin po flasim. Përndryshe, pavarësisht mbrojtjes që po japin këto muaj në këtë mënyrë të sforcuar, do të biem përsëri në të njëjtën situatë që ishte edhe më herët që reflekton edhe përqendrim të tregjeve, edhe mungesë të konkurrencës, që do të thotë kërkohet një rol proaktiv i të gjitha institucioneve dhe, mbi të gjitha, i Komisionit të Konkurrencës. Nuk mjafton një ankesë e ardhur apo një kronikë televizive, duhet të ridimensionohet roli i Autoritetit të Konkurrencës për të bërë pikërisht këtë gjë, roli proaktiv, natyrisht, brenda kufijve të ligjit në secilin prej tregjeve që kanë ndikim mbi konsumatorin.

E treta, pa diskutim, roli i qeverisë në dhënien e të drejtave ekskluzive apo koncesioneve të partneritetit publik-privat me ligj është kufizuar. Pra, fushat nuk janë më të gjera e kështu me radhë, por kjo nuk do të thotë që qeveria të mos zbatojë të gjitha detyrimet që ka ndaj agjencive dhe, natyrisht, ndaj tregjeve. Pa diskutim, që qeveria ka interesa në bazë të programit dhe qëllimeve politike që ka, por, mbi të gjitha, është shumë e rëndësishme që në asnjë rast nuk duhet që ndërhyrja e saj edhe me të tilla instrumente të deformojë konkurrencën në treg. Kjo do të thotë që, nëse pritet që thjesht dhe vetëm qeveria t'i drejtohet Komisionit të Konkurrencës, gjë që e ka detyrë dhe duhet ta bëjë, pa diskutim, dhe t'i kërkojë miratim për çdo akt që ndikon drejtpërdrejt në treg dhe në konkurrencën në treg për çdo muaj, ndërkohë që vendimet bëhen fakte dhe faktet ndikojnë drejtpërdrejt në treg, natyrisht që duhet parë se si ridimensionohet roli i Autoritetit të Konkurrencës edhe për këtë gjë. Është shumë e rëndësishme që të ndodhë kjo dhe ka përvoja të ndryshme *postfactum*, që nuk kanë dhënë ndonjë rezultat, që para vitit 2013 me privatizimin e ARMO-s, pastaj me një vendim të Këshillit të Ministrave po përsëri për naftën “virgin” e të tjera me radhë, që nuk u përfill Autoriteti i Konkurrencës përpara se të merreshin këto vendime, por nuk u përfill as pasi mori vendimin. Asgjë nuk u zhbë, ashtu edhe sot kur vendimet e Këshillit të Ministrave, veçanërisht në tregun e plehrave kimike, kanë përqendruar tregun, kanë zbehur konkurrencën dhe, natyrisht, kanë sjellë në atë vendimmarrje. Në hetimin apo në vendimin që Autoriteti i Konkurrencës ka marrë për këtë çështje nuk përfshihet asnjë rekomandim për ndryshimin e bazës nënligjore, sepse ligji nuk i njihë ekskluzivitetet. Vendimi i Këshillit të

Ministrave dhe disa udhëzime që kanë dalë pas tij, natyrisht, kanë bërë këtë gjë dhe është themelore që Autoriteti i Konkurrencës të bëjë detyrën e tij edhe në këtë aspekt, pavarësisht se kush është në pushtet e pavarësisht fuqisë që ka pushteti ekzekutiv natyral apo edhe abuziv, po të doni, në këtë rast. Kështu që është themelore që, veç monitorimit të tregjeve, të shkohet deri në rekomandime, përmes vendimeve për të ndryshuar vendimmarrjet e qeverisë aty ku kjo vendimmarrje ka cenuar konkurrencën në treg.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Braçe!

Zonja Tabaku.

Jorida Tabaku – Faleminderit, kryetar!

Së pari, unë besoj se do të kemi kohë bashkërisht për të diskutuar rekomandimet, rezolutën e përbashkët, në qoftë se do të dalim me një rezolutë, por mendoj se ka çështje më përmbajtjesore që ne duhet të theksojmë si anëtarë të këtij komisioni. Unë kam mbajtur disa shënime gjatë diskutimeve të ditës së sotme.

Së dyti, unë do të kisha shpresuar nga kryetari që sot diskutimi të ishte pak më praktik dhe jo teorik. Të them të drejtën, nuk e di për kolegët tjerë, por unë nuk mora asnjë përgjigje për pyetjet dhe për shqetësimet që ngrita. Roli juaj nuk është një rol profesorësh që flasin në përgjithësi, që merren me përafrim legjislacioni, që luajnë një rol akademik, por roli juaj është konkret për të monitoruar tregjet dhe, në qoftë se ky funksion nuk ushtrohet tani kur ka më shumë nevojë me këtë rritje të jashtëzakonshme çmimesh në përgjithësi nga Autoriteti i Konkurrencës, unë nuk e di se kur mund të ushtrohet.

Ngrita shqetësimin për sa i përket vajit vegjetal, meqenëse ishte një hetim që ju kishit marrë, por rritja e përgjithshme e çmimeve të shportës ka qenë një shqetësim që unë e kam ngritur që nga shtatori. Edhe në informacionin që ju keni përgatitur, e përmendni rritjen që përpara rritjes së përgjithshme të çmimeve, i referoheni dhjetorit të vitit të mëparshëm dhe besoj se është në interesin qytetar që Autoriteti i Konkurrencës të ngrihet mbi palët dhe në këtë rast mbi palët politike për të ushtruar funksionin e tij. Në qoftë se, kryetar, Autoriteti i Konkurrencës e ka të pamundur ta bëjë këtë, atëherë ju takon juve, në rolin e drejtuesit të këtij komisioni, që ta vendosni qeverinë përpara përgjegjësisë. Unë nuk besoj se autoriteti do të jetë një zgjatim i qeverisë dhe për këtë arsye insistova që duhet të krijojmë edhe një balancë të përfaqësimit në Autoritetin e Konkurrencës për të pasur edhe mendimin ndryshe në këtë autoritet, duke pasur

parasysh se kush mund t'i propozojë përfaqësuesit e mendimit ndryshe. Unë kam ngritur disa shqetësime, të cilat shpresoj që të jenë edhe pjesë e rezolutës.

Së pari, luajtja e një roli aktiv nga Autoriteti i Konkurrencës për sa i përket rritjes së përgjithshme të çmimeve në treg dhe hetime, të cilat mund të jenë me një periudhë kohore më të shkurtër. Ndërkohë që Autoriteti i Konkurrencës merr një vendim, i cili ankimohet, shkon në gjykatë dhe gjobat mund të pezullohen; dinamika në tregje, sigurisht, që ndryshon. Nuk dua të ndalem në tregun e hidrokarbureve, të cilin e përmendi zoti Braçe, por unë ju pyeta konkretisht për *"Bankers Petroleum"* dhe nuk arrita të marr këtu një përgjigje. Kjo na takon neve si Komisioni i Ekonomisë për të parë rolin e Bankers në këtë situatë të rritjes së çmimeve; çfarë po ndodh me institucionin që mund të ishte në lartësinë për të rregulluar çmimet këtu në tregun shqiptar. Nuk kemi absolutisht asnjë informacion se çfarë ndodh me këtë institucion për produktet e shportës, për miellin dhe për grurin. Pra, këtu po diskutojmë për produkte jetike, që lidhin rritjen e çmimeve në të gjithë zinxhirin e ekonomisë dhe jo për produkte, të cilat mund të konsiderohen si produkte të veçanta, produkte luksi. Kur iu referova listës, iu referova punës proaktive të Autoritetit të Konkurrencës për këto lloj produktesh.

Unë besoj, kryetar, se Autoriteti i Konkurrencës duhet të ndryshojë qasjen që qeveria e premtoi që në vitin 2013, në fakt, qasje që unë nuk e kam parë që të ketë ndryshuar në këta 8 vjet dhe, fatkeqësisht, është ende e pandryshuar.

Autoriteti i Konkurrencës duhej të ishte oponenta kryesore e qeverisë për sa u përket ligjeve speciale, përqendrimit të tregjeve, të drejtave ekskluzive, të cilat në 8 vjetët e fundit janë rritur dhe i takon kryetarit të këtij komisioni që të luajë rolin kësaj oponente bashkë me anëtarët e këtij komisioni për të ruajtur, sigurisht, balancën në tregje dhe për të mos prishur konkurrencën. Unë besoj se ka detyra dhe sfida shumë të rëndësishme përpara. Nga ky komision ne mund të japim mbështetje të pakursyer, pavarësisht kaheve politike, por punën e institucionit ne nuk e kryejmë dot.

Kur iu referova vendimit të gjykatës, iu referova faktit që Autoriteti i Konkurrencës ka disa tregues që masin performancën, krahasuar me vende të tjera të rajonit, stafi, buxheti mund të jenë disa tregues, por disa tregues të tjerë janë edhe vendimet, apelimi i tyre, fakti se sa prej tyre zbatohen e kështu me radhe dhe jo për të treguar që ndoshta një vendim gjykate mund të rrëzojë punë e komisionit. Kur iu referova edhe treguesit që ka vetëm një gjobë, unë vazhdoj dhe gjykoj ende, ndryshe nga kryetari i këtij komisioni, i cili thotë se mund të dalin kompani nga tregu që

asnjë nga kompanitë që ju mund t'i vendosni gjobë, nuk rrezikon të dalë nga tregu. Këtu bëhet fjalë për struktura oligopol, në disa raste kemi monopol, ka tregje që kanë që të gjitha kompani, të cilat siç duket po përfitojnë nga kriza dhe është detyra juaj që të evidentoni këto kompani që po përfitojnë nga kriza në dëm të interesit qytetar për të ruajtur konkurrencën në treg dhe për të pasur një balancë të tregut. Ndryshe nga kolegët e tjerë, vendosja e një bordi për çmimet nuk më duket zgjidhja e duhur, në qoftë se ne do të kishim një ekonomi tregu funksionale dhe, fatkeqësisht, në raportin e progresit të vit pas viti Autoriteti i Konkurrencës nuk ka asnjë ndryshim. Shqipëria ka bërë njëfarë progresi dhe ka një nivel përgatitjeje për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së, thotë progresraporti, nuk ka absolutisht asnjë ndryshim në performancën e institucionit dhe në rritjen e vlerësimit të institucionit, ashtu sikurse edhe në përafrimin e legjislacionit, por kjo nuk lidhet me funksionin tuaj për ruajtjen e tregut.

Kështu, besoj se duhet ta bëjmë pak më konkrete rezolutën, të vendosim disa elemente konkrete, që lidhen me punën e institucionit, por, njëkohësisht, edhe me sektorët që mund të kemi në monitorim. Besoj se të gjithë mund të japin një kontribut dhe kemi pak kohë për këtë, ashtu siç i kërkoj edhe kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës që, pavarësisht shpeshtisë që mund të vijë këtu, ne kemi nevojë për gjëra praktike, se në fund të ditës jemi të gjithë deputetë, siç e kam thënë edhe para dy muajsh, që jemi zgjedhur nga qytetarët për të diskutuar gjëra që prekin qytetarët dhe jo për teori akademike që ndoshta nuk i takojnë këtij institucioni, por u takojnë instancave të tjera.

Faleminderit kryetar!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Tabaku!

Pavarësisht se nuk bie dakord me një pjesë të atyre që ju konkludoni, por dy relatorët janë në dispozicion të sugjerimeve nga deputetët, të cilët pastaj do t'i gjejnë bashkërisht në hartimin e rezolutës, të cilën e konsideroj shumë të rëndësishme, por më mbetet merak që kërkohet diçka dhe nuk pasohet nga deputetët, kështu që jeni shumë të mirëpritur për të pasuruar rezolutën.

Zonja Gjylameti keni fjalën.

Jemi në fund të diskutimeve...

Blerina Gjylameti – Patjetër!

Faleminderit kryetar!

Unë i dëgjova me shumë vëmendje të gjitha sugjerimet e kolegëve, po ashtu dëgjova me shumë vëmendje edhe pyetjet, që u adresohen përfaqësuesve të Autoritetit të Konkurrencës, të gjithë ekipit. Ndërkohë, dëgjova me shumë vëmendje edhe shqetësimet që u ngritën dhe, më vjen keq ta them, edhe pse kemi ndryshuar komplet qasjen e bashkëpunimit mes pozitës dhe opozitës në këtë komision, përsëri vazhdojmë me të njëjtën metodë dhe stil të dikurshëm.

Projektrezoluta ka qenë në dispozicion të çdo anëtari të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe ndërkohë ne si kryesi komisioni dhe të dyja relatorët, qoftë edhe me Shërbimin e Monitorimit të Kuvendit, jemi ulur disa herë për monitorimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, po ashtu për monitorimin e rekomandimeve të lëna dhe implementimit të tyre gjatë aktivitetit 2021, por edhe për të diskutuar të gjitha rekomandimet që duhet të ishin në projektrezolutën e këtij viti. Kështu që, unë besoj se të gjitha çka u ngritën këtu, nëse do të ishin bërë në kohë, ndoshta do t'i kishim evituar dhe nuk do të krijonim debate, që nuk shërbejnë dhe nuk janë konstruktive për punën tonë.

Ndërkohë, në anën tjetër, zonja Tabaku u largua, unë i dëgjova me shumë vëmendje të gjitha shqetësimet që ka pasur. Me sa duket ajo nuk më ka dëgjuar mua ndërsa relatova, së bashku me kolegen time të opozitës, për pjesën e projektrezolutës, ku të gjitha shqetësimet që u ngritën ishin të adresuara paraprakisht në atë projektrezolutë. Nëse ne do të duam të përdorim foltoren e këtij komisioni për pjesën e debatit politik, patjetër ne politikanë jemi, ndërkohë që akuzojmë pjesën tjetër se do të duhet të jemi më konstruktivë, më të qartë, më konkretë, më praktikë, po aq duhet të jemi edhe vetë kur i ngremë këto shqetësime për të tjerët.

Ndërkohë, besoj se për sa i përket Autoritetit të Konkurrencës është shumë e rëndësishme të shpjegojmë rolin dhe funksionin e tij. Ne si deputetë, por edhe si qytetarë të Republikës së Shqipërisë jemi të gjithë të shqetësuar me atë që ndodh në tregjet e vendit, po ashtu shumë të shqetësuar me spekulimet e çmimeve, sidomos me çmimet e shportës, në mënyrë të veçantë, por edhe me ato të tregut të karburanteve, me ato marrëveshje të fshehta që mund të jenë bërë apo për qëndrimet që mund të ketë në treg dhe, siç e thashë pak më parë, spekulimet që bëhen me të gjitha çmimet, por kjo nuk duhet të na konfundojë me rolin e Autoritetit të Konkurrencës. Jam më se e bindur se shqetësimet që kemi duhet t'i adresojmë në institucionet përkatëse. Qëndrimi im është se edhe pse bordi i transparencës është një masë e jashtëzakonshme, e cila nuk merret në kushtet normale të funksionimit të tregut, por merret në situatë të jashtëzakonshme, sikundër është kjo që solli ndikimi i krizës së agresionit rus në çështjet e brendshme apo në pjesën e

ekonomisë shqiptare, unë besoj që ka dhënë rezultate që janë të mira dhe kanë të bëjnë me uljen e spekulimit që është bërë në treg apo të abuzimit me çmimet.

Ndërkohë, besoj se roli i Autoritetit të Konkurrencës, është e vërtetë, duhet të jetë më proaktiv, patjetër që po, duhet të ndërmarrë monitorime të vazhdueshme për sa u përket edhe hetimeve, analizave në tregje sensitive, sikundër është ky i shportës dhe ka synim mirëqenien e konsumatorit, po ashtu i tregtimit të vajit vegjetal, tregtimit të karburanteve. Pra, edhe pse gjatë vitit të kaluar kanë bërë monitorime, duhet të jenë më proaktiv në këto tregje. Një tjetër rast që duhet monitoruar është tregu i shërbimeve të telefonisë celulare, sepse shikojmë që ka një përqendrim, që është përqendrim i autorizuar, por ndërkohë duhet të shohim se çfarë efektesh do të sjellë në treg ky lloj përqendrimi. Besoj, gjithashtu, se duhet të jenë më proaktiv në sigurimin e konkurrencës së lirë në treg dhe në pjesën e përqendrimeve, që janë krijuar tashmë në treg.

Nga ana tjetër, mendoj se është shumë e rëndësishme për publikun të kemi një transparencë të shtuar për sa i përket të gjithë pjesës së vendimmarrjes, por në mënyrë të posaçme informacionit apo informimit më të gjerë të publikut për të gjitha ato çështje që janë me interes të veçantë.

Gjithashtu, duhet të vijojmë më tej me përafrimin e legjislacionit me direktivat e Bashkimit Europian dhe të nxitojmë të gjithë punën që duhet bërë, për të sjellë ligjin e ndryshuar, i cili ua jep edhe mundësinë dhe nga ana jonë duhet t'u rekomandojmë institucioneve të tjera të kërkojnë paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt, akt normativ, që ka si objekt pasojën e dhënies së të drejtave ekskluzive apo kufizimeve sasiore, cilësore të konkurrencës në tregje. Besoj se duhet të ketë një rol më proaktiv të Autoritetit të Konkurrencës për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore, me qëllimin e vetëm sigurimin e një konkurrence të lirë dhe sa më efektive në treg.

Ky ishte në linja të përgjithshme. Besoj se të gjitha sugjerimet e kolegëve do t'i kemi pjesë të reflektuara në draftrezolutë, por ndërkohë duhet theksuar se është hera e parë, në absolut, që ne arrijmë të jemi të dyja palët me synimin e vetëm që për të gjitha ato institucione të pavarura, në draftrezolutat apo rezolutat, të marrim mendimin e të dyja palëve, por kjo nuk duhet të përdoret politikisht për të pasur një avantazh. Synimi dhe qëllimi ynë janë qytetarët dhe jo avantazhi politik që mund të ketë njëra ose tjetra palë, duke vënë në dukje çfarë do të duhej bërë ndryshe, ndërkohë kur duhet të japin alternativë, nuk e japin atë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Me fjalën e zonjës Gjylameti e përmbylim. Dua vetëm një afat kohor 2-3-ditor, deri të premtën, për sugjerimet e kolegëve deputetë.

Duke falënderuar kryetarin dhe anëtarët e nderuar të komisionit, gjithashtu edhe deputetët për debatin, dua ta përmbyll me fjalën e një njeriu të mirënjohur, e kam në anglisht në fakt, e përdori me term tjetër, ishte lapsus, për humor: “Konkurrenca nuk ka të bëjë, thotë, me numrin e kompanive që operojnë në treg, por me procesin nëpërmjet të cilit forcat e tregut operojnë lirisht për të siguruar që burimet e shoqërisë po përdoren në mënyrë eficiente, sa të maksimizojnë mirëqenien totale ekonomike”. Thelbi: nuk e bën një treg më konkurrues numri i kompanive sesa eficientia e kompanive.

Gjithsesi, mendoj se kemi hapur një udhë të re komunikimi midis parlamentit dhe Autoritetit të Konkurrencës, jemi larg imponimeve të së kaluarës, kur ndoshta procese të ndryshme hetimi inicioheshin. Dua ta forcojmë këtë mënyrë komunikimi.

Do ta fillojmë me rezolutën, relatorëve përkatës u kërkoj që brenda 2 ditëve të marrin edhe sugjerimet e deputetëve të tjerë dhe për të vijuar, siç thashë, na intereson një institucion i pavarur, profesionist, i kompletuar nga pikëpamja e burimeve njerëzore dhe logjistike, por duke mos pasur iluzionin, që rëndom del nga banakët televizivë, se do të jetë institucioni që do të rregullojë ekonominë shqiptare, ka një keqkuptim të madh.

Gjithsesi, falënderoj edhe anëtarët, edhe sekretaren, edhe shefin e kabinetit për praninë!

Do të rishihemi përsëri.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare e komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar administrativ
Elvi Prifti